



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 456 Akti

Nr. 539 Vendimi
Tiranë, më 8.6.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare znj. Elka Ermenkova, në datën 27.5.2022, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Hysni Mulaj**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç, dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Hysni Mulaj, me detyrë prokuror në Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 16.12.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Trupi gjykues, i shortuar për të shqyrtuar çështjen, përbëhet nga komisionerët: Suela Zhegu me cilësinë e relatores, Brunilda Bekteshi me cilësinë e kryesueses dhe Firdes Shuli, anëtare. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 23.12.2019 u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues komisionere Brunilda Bekteshi.

3. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Elka Ermenkova.

4. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët.

5. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, si dhe veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

6. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

7. **ILDKPKI-ja**, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me burimin financiar të babait të subjektit;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

¹Raporti i ILDKPKI-së, i dërguar me shkresën nr *** prot., datë 11.4.2018.

8. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport² të arsyetuar, ku fillimisht ka konstatuar “*përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*” dhe më pas ka ndryshuar³ konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, duke konkluduar në “*papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Hysni Mulaj*”.

9. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport⁴ të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.

10. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

11. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 4.3.2022, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Hysni Mulaj, njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke i kaluar subjektit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

12. Me vendimin datë 4.4.2022, trupi gjykues vendosi riçeljen e hetimit administrativ për subjektin Hysni Mulaj vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe me vendimin e datës 12.4.2022 vendosi të riçelë hetimin administrativ edhe për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Në datën 20.5.2022 subjekti u njoftua për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, si dhe me rezultatet e hetimit shtesë.

13. Për një proces të rregullt ligjor subjektit të rivlerësimit Hysni Mulaj i janë garantuar të drejtat, si: njoftimi për fillimin e procedurës së rivlerësimit; njoftimi mbi përbërjen e trupit gjykues; si dhe për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit.

14. Z. Hysni Mulaj, pasi u njoh me rezultatet e hetimit administrativ, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e tij në datat 18.3.2022, 31.3.2022 dhe 26.5.2022. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit, deklaroi se është pjesërisht dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe të provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e kryer elektronikisht në datën 23.3.2022. Trupi gjykues, pas prapësimeve dhe provave të depozituara nga subjekti

²Raporti i kontrollit të figurës i dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. *** datë 9.12.2020, të KDZH-së.

³Shkresë nr. *** prot., datë 1.12.2020, e DSIK-së.

⁴Raporti nr. *** prot., datë 27.4.2021, i KLP-së.

vendosi të riçelë hetimin administrativ për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

16. Pas mbylljes së hetimit administrativ shtesë, në datën 19.5.2022, subjekti u njoh me hetimin shtesë në datën 20.5.2022 dhe u ftua sërish në seancë dëgjimore.

17. Seancat dëgjimore për subjektin Hysni Mulaj u zhvilluan në datat 25.3.2022 dhe 27.5.2022, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova.

18. Në këto seanca, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi pjesërisht rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Subjekti i rivlerësimit Hysni Mulaj ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, z. Hysni Mulaj ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

22. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

23. Ndërsa, sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

24. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

25. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
- e) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f) raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
- g) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

26. Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Hysni Mulaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, u krye mbi bazën e tri kriterëve: vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore, me burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, mundësitë për fshehje të pasurisë, deklaratim të rremë apo konfliktin e interesit.

Në deklaratën e pasurisë *Vetting* (shtojca 2), dorëzuar në ILDKPKI, në datën 20.1.2017, subjekti ka deklaruar pasuritë në vijim:

1. Apartament⁵ me sipërfaqe 101.4 m², blerë më 14.1.2004, në Kinostudio, Tiranë

Vlera e deklaruar :	39.546 euro.
Burimi i krijimit:	subjekti ka deklaruar hua në shumën 4.000.000 lekë, të marrë nga babai R.M në vitin 2004 dhe dhuratë në shumën 500.000 lekë, dhënë nga babai në vitin 2005.
Mënyra e fitimit:	me kontratë sipërmarrje/porosie nr. *** rep., datë 14.1.2004.
Në DPV-në e vitit 2004:	subjekti ka deklaruar shumën 4.000.000 lekë, marrë hua nga babai R.M, e përdorur për blerjen e apartamentit.
Në DPV e vitit 2005:	subjekti ka deklaruar shumën 500.000 lekë <i>cash</i> , marrë dhuratë më 8.1.2005, nga babai R.M.

1.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Hysni Mulaj ka porositur një apartament me sipërfaqe totale ndërtimi 101.4 m² me gjithë ambientet ndihmëse (e përbërë nga dy dhoma e kuzhinë), i ndodhur në Kinostudio, Tiranë, në vlerën 39.546 euro, për të cilën ka lidhur kontratë sipërmarrje/porosie datë 14.1.2004, me shoqërinë sipërmarrëse “M” sh.p.k., e pajisur me lejë ndërtimore datë 21.12.2002, nga KRRT-ja Tiranë.

⁵Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (1) kontratë sipërmarrje/porosie nr. *** rep., datë 14.1.2004, me sipërmarrës “M” sh.p.k., me administrator, z. E.M dhe porositës z. Hysni Mulaj, për ndërtimin një apartamenti me sip. 101.4 m² në vlerën 39.546 euro. Bashkëlidhur kontratës ndodhet leje ndërtimi (formulari nr. 4) datë 21.11.2020, vendim nr. **, datë 24.5.2002, i KRRT-së dhe vendim me nr. *** prot., datë 24.6.2002, i Këshillit të Rregullimit të Territorit; (2) deklaratë noteriale nr. *** rep., datë 16.6.2004, nga shoqëria “M” sh.p.k. dhe z. Hysni Mulaj, ku konfirmohet pagesa e shumës 19.000 euro, më 14.1.2004, shuma 10.000 euro më 16.6.2004 dhe pjesa e mbetur do të shlyhet në vazhdim; (3) mandatarëkëtimi nr. **, datë 14.1.2004, për pagesën e shumës 19.000 euro nga z. Hysni Mulaj për shoqërinë “M” sh.p.k.; mandatpagese datë 6.6.2004 për pagesën e shumës 10.000 euro, si dhe mandatpagesë nr. ***, datë 14.2.2005 për pagesën e shumës 10.500 euro nga z. Hysni Mulaj për shoqërinë “M” sh.p.k.

Komisioni ka kërkuar informacion pranë ASHK-së Tiranë⁶, e cila ka informuar se nuk figurojnë pasuri të regjistruara në emër të z. Hysni Mulaj dhe personave të lidhur.

Nga kërkimi i kryer në sistemin elektronik të ASHK-së, në emër të shtetasit Hysni R. Mulaj ka rezultuar një apartament me sip. 91.9 m², i regjistruar në datën 25.5.2021, me nr. pasurie ***/ND+*-**, me status “regjistrim i përkohshëm”. Referuar kartelës së pasurisë, në seksionin “D”, mbi këtë pasuri ka kufizim deri në shlyerjen e veprimeve për truallin.

Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime lidhur me këtë apartament, për të cilin subjekti ka shpjeguar⁷ se nga ana e ndërtuesit nuk është treguar korrektësi, duke braktisur procesin e marrjes së hipotekës, për shkak të punimeve të kryera jashtë projektit të miratuar nga KRRT-ja.

Për këtë arsye, me qëllim pajisjen me certifikatë pronësie, subjekti ka aplikuar në datën 12.4.2021 për legalizim të ndërtimit pa leje dhe pas marrjes së lejes së legalizimit, me vendimin nr. ***, datë 14.4.2021, të ASHK-së Drejtoria Vendore Tiranë Veri, ka aplikuar për regjistrimin e pronësisë së apartamentit duke u pajisur me certifikatë pronësie. Subjekti depozitoi dokumentacionin provues⁸, ku provohet regjistrimi i apartamentit përmes procedurave të legalizimit, në shkelje të lejes ndërtimore.

Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko - ligjor të pasurisë së administruar nga ASHK-ja Tiranë Veri⁹ ka rezultuar se apartamenti është i regjistruar në bazë të vendimit nr. ***, datë 14.4.2021, të Drejtorisë Vendore Tiranë Veri për legalizimin e ndërtimit pa leje, në shkelje të lejes ndërtimore.

1.2 Në lidhje me pagesat e kryera për blerjen e kësaj pasurie

Referuar kontratës së sipërmarrjes/porosisë datë 14.1.2004 të lidhur midis subjektit dhe shoqërisë sipërmarrëse “M” sh.p.k., palët kanë përcaktuar se pagesa e apartamentit në shumën 39.546 euro do të kryhej me këste, ku: (i) kësti i parë prej 19.000 euro u pagua në datën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes; (ii) kësti i dytë do të paguhet në përfundimin e rrethimit me tulla; (iii) kësti i tretë do të paguhet në përfundim të suvatimit.

Nga hetimi ka rezultuar se pagesat për blerjen e apartamentit janë kryer me tri këste pranë shoqërisë “M” sh.p.k., sipas mandatpagesave në vijim: (i) shuma 19.000 euro është paguar me mandatarëkëtimin nr. **, datë 14.1.2004; (ii) shuma 10.000 euro është paguar përmes mandatpagesës datë 16.6.2004; (iii) shuma 10.500 euro është paguar përmes mandatpagesës nr. **, datë 14.2.2005.

Lidhur me dy këstet e paguara në vitin 2004, subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale¹⁰ datë 16.6.2004, përmes së cilës shoqëria “M” sh.p.k. konfirmon pagesën e këtyre dy kësteve, ndërsa pjesa tjetër do të shlyhej në vazhdim.

⁶Shkresat: nr. *** prot., datë 4.9.2020, e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 1; nr. *** prot., datë 15.9.2020, e Drejtorisë Vendore Tiranë Rurale 2; nr. *** prot., datë 17.9.2020, e Drejtorisë Vendore Tiranë Jug; nr. *** prot., datë 18.9.2020 e Drejtorisë Vendore Tiranë Veri.

⁷Shpjegimet e subjektit datë 28.12.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 21.12.2021.

⁸Dokumentacion i depozituar nga subjekti me e-mail datë 28.12.2021: kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., datë 14.1.2004, lidhur me shoqërinë ndërtuese “M” (2 fletë); kërkesë me nr. ***, datë 12.4.2021, për legalizimin e ndërtimit pa leje (1 fletë); vendim nr. ***, datë 14.4.2021, për legalizimin e ndërtimit pa leje + genplan (3 fletë); kërkesë datë 20.5.2021 për pajisjen me certifikatë pronësie dhe kartelë pasurie; certifikatë regjistrimi pronësie për apartamentin me sip. 91.9 m², me nr. pasurie ***/ND+*-**, datë 25.5.2021; kartelë e pasurisë me kod unik *** (3 fletë).

⁹ASHK-ja Tiranë Veri me shkresën nr. *** prot., datë 22.12.2021, ka dërguar dokumentacionin e pasurisë nr. ***/ND+*-**: kartela e pasurisë së paluajtshme e lëshuar në datën 13.12.2021; vendim nr. ***, datë 14.4.2021, “Për legalizimin e ndërtimit pa leje” në emër të shtetasit Hysni R. Mulaj, i lëshuar nga Drejtoria Vendore Tiranë Veri (1 faqe); genplan dhe planimetri e ap. 12, kati i tretë.

¹⁰Deklaratë noteriale nr. *** rep., datë 16.6.2004, e njehsuar me origjinalin me vërtetim nr. *** rep., datë 19.1.2017.

Sa i përket kështit të tretë në shumën 10.500 euro të paguar në vitin 2005, Komisioni i ka kërkuar¹¹ subjektit të deklarojë burimin e ligjshëm që ka shërbyer për këtë pagesë, për të cilën subjekti ka shpjeguar¹² se: *“Në lidhje me pagesën e kështit prej 10.500 euro, burim për pagesën e kësaj shume ka qenë gjendja cash e një shume të siguruar nga paga e vitit 2004, prej 700.000 lekësh, e deklaruar nga ana ime si dhe shuma e dhënë dhuratë në vitin 2005, nga babai në masën 500.000 lekë”*.

Nga verifikimi i deklarimeve periodike në vitet 2004 -2005, subjekti ka deklaruar në DPV (deklarimin periodik vjetor) e vitit 2004 gjendjen cash prej 700.000 lekë si dhe pakësimin e kësaj gjendje në DPV-në e vitit 2005. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar¹³ dhuratën prej 500.000 lekë të marrë cash nga babai R.M në datë 8.1.2005.

1.2.1 Referuar procesverbaleve të mbajtura në ILDKPKI¹⁴, subjekti është pyetur, ndër të tjera, nëse ka pasur kontribut bashkëshortja e tij R.N, në blerjen e apartamentit, kjo për faktin se në vitin 2003 ka pasur dy depozitime të kryera në “Intesa Sanpaolo Bank” nga bashkëshortja e tij (e cila nuk ka qenë subjekt deklarimi, pasi është martuar në vitin 2007) në vlerën 4.000.000 lekë.

Në shpjegimet e tij, subjekti ka deklaruar¹⁵ se nuk ka dijeni lidhur me këto depozita dhe bashkëshortja nuk ka kontribut në blerjen e këtij apartamenti, pasi është martuar me të në vitin 2007.

Komisioni i ka kërkuar¹⁶ subjektit të japë shpjegime lidhur me dy transaksione bankare (tërheqje *cash*) të kryera nga bashkëshortja e tij në “Intesa Sanpaolo Bank”, të cilat përkojnë me pagesën e kësteve për blerjen e apartamentit. Subjekti ka shpjeguar¹⁷ se është vënë në dijeni mbi ekzistencën e kësaj llogarie në vitin 2016, nga ILDKPKI-ja, duke sqaruar se nuk ka pasur dijeni për këtë llogari të shtetases R.N (e cila më pas u bë bashkëshortja e tij), e cila nuk ka kontribuar asnjë lekë në blerjen e apartamentit prej tij në vitin 2004, pasi në atë kohë nuk ka pasur as njohje të niveleve të tilla konfidenciale me shtetasen R.N.

Sa i përket tërheqjes së këtyre shumave nga llogaria e shtetases R.N(periudhë në të cilën bashkëshortja nuk ka qenë subjekt që mbart detyrimin për deklarim të pasurisë), subjekti ka shpjeguar se këto shuma nuk janë të njëjta me shumën e mandateve. Sipas subjektit, në blerjen e këtij apartamenti, përveç të ardhurave të tij dhe familjes, nuk ka kontribuar asnjë person tjetër.

Referuar dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se në momentin e blerjes së apartamentit në datën 14.1.2004, subjekti ka qenë në një certifikatë familjare¹⁸ me gjyshen dhe vëllain e tij në periudhën 1991 – 2007, me gjendje civile “beqar” (martuar në datën 30.5.2007)¹⁹.

1.2.2 Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt interesi të mundshëm të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë sipërmarrëse “M” sh.p.k. dhe administratorin, z. E.M, nga përgjigjet

¹¹Përmes pyetësorit me e-mail datë 8.5.2020.

¹²Shpjegimet e subjektit me e-mail datë 21.5.2020, në përgjigje të pyetësorit datë 8.5.2020.

¹³Në DPV-në e vitit 2005, te rubrika “dhurata dhe trajtime preferenciale”.

¹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 10.12.2021.

¹⁵Procesverbali mbi shpjegimet e subjektit, i mbajtur në ILDKPKI, në datën 8.1.2016.

¹⁶Përmes pyetësorit datë 8.2.2022.

¹⁷Shpjegimet e subjektit me e-mail datë 10.2.2022, në përgjigje të pyetësorit datë 8.2.2022.

¹⁸sipas certifikatës familjare datë 16.1.2020 të Zyrës së Gjendjes Civile Tropojë (përbërja familjare nga data 11.2.1991 – 22.4.2007).

¹⁹Sipas certifikatës së martesës datë 21.10.2016 të Njësisë Bashkiake Nr. *, Tiranë (e depozituar nga subjekti në pyetësorin standard).

e ardhura nga Prokuroritë²⁰ e Rretheve Tropojë, Dibër dhe Tiranë, ku subjekti ka ushtruar funksionin e prokurorit, nuk rezultoi që shoqëria ndërtuese apo administratori i saj të jenë hetuar apo proceduar nga prokurori Hysni Mulaj.

Nga analizimi i akteve të administruara në dosje nuk u evidentua ndonjë problematikë.

1.2.3 Sa i takon çmimit të blerjes së këtij apartamenti, Komisioni ka verifikuar koston e ndërtimit dhe vlerën e tregut të lirë të apartamenteve, referuar çmimit të EKB-së²¹ në vitin 2004, ku për apartamentet e ndodhura në gjithë territorin e Tiranës, të papërcaktuar me zona specifike, kostoja e ndërtimit është në vlerën 24.446 lekë, pra, çmimi i përgjithshëm i apartamentit me sipërfaqe ndërtimi 101.4 m² do të ishte 2.478.824 lekë (19.558 euro), ndërsa vlera në tregun e lirë në vitin 2004 është 68.571 lekë/m², ku çmimi i apartamentit do të ishte në vlerën 6.953.099 lekë (54.861 euro).

Nga hetimi nuk ngrihen dyshime mbi çmimin real të blerjes së apartamentit, duke marrë në konsideratë faktin se apartamenti është blerë në fazë ndërtimi.

1.3 Komisioni analizoi burimet e krijimit të pasurisë apartament

Në deklaratën *Vetting* dhe në DPV-në e vitit 2004, në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit:

- hua në shumën 4.000.000 lekë të marrë nga babai R.M në vitin 2004; si dhe
- shuma 500.000 lekë, dhënë dhuratë nga babai, ku shuma e detyrimit financiar e mbetur e pashlyer deri në datën e fillimit të rivlerësimit është në vlerën 1.780.000 lekë.

Subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale²² datë 1.12.2011, të lëshuar nga babai z. R.M, i cili ka deklaruar se në janar të vitit 2004 i ka dhënë djalit të tij Hysni Mulaj shumën 4.000.000 lekë për ta ndihmuar për të përballuar problemet e jetesës në Tiranë, me kushtin që kur të përmirësohet gjendja financiare e tij t’i kthejë. Gjithashtu, ka deklaruar se i ka dhuruar shumën 500.000 lekë në janar të vitit 2005, me burim nga të ardhurat dhe kursimet e tij personale.

Gjatë hetimit, subjekti shpjegoi²³ se dhënia e huas dhe dhuratës nga babai është kryer *cash*.

Komisioni i ka kërkuar²⁴ subjektit të depozitojë dokumentacion provues mbi të ardhurat e ligjshme të babait për shumën e dhënë hua prej 4.000.000 lekësh dhe dhuratën në vlerën 500.000 lekë.

Subjekti ka shpjeguar²⁵ se burimi i këtyre të ardhurave ka qenë kontributi i vazhdueshëm i të gjithë anëtarëve të familjes për faktin se familja e tij ka funksionuar si një familje e madhe, duke respektuar traditën e zonës, e cila drejtohej nga babai si kryefamijar dhe të gjitha të ardhurat e siguruar nga çdo anëtar i familjes administroheshin nga babai.

Sipas shpjegimeve²⁶ të subjektit për blerjen e apartamentit, pjesa me e madhe e burimit financiar ka qenë huaja e marrë babait R.M, ku si burim i të ardhurave të babait kanë qenë: (i) kontributi i vazhdueshëm nga paga e subjektit; (ii) të ardhurat nga aktiviteti i biznesit të babait; (iii) pensionet e prindërve; (iv) kontributet e vazhdueshme të vëllezërve të cilët kanë qenë dhe janë të punësuar në shtet (polici dhe bashki) dhe njëri në emigracion (Belgjikë); (v) të ardhurat

²⁰Shkresat: nr. *** prot., datë 18.11.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë; nr. *** prot., datë 13.12.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. ***, datë 15.12.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

²¹Udhëzimi nr. 1, datë 4.3.2004, i EKB-së.

²²Deklaratë noteriale nr. ***, datë 1.12.2011, e njehsuar me origjinalin me vërtetimin nr. *** rep., datë 25.10.2016.

²³Përgjigje e subjektit me e-mail datë 28.5.2020.

²⁴Përmes pyetësorit datë 8.5.2020.

²⁵Shpjegimet e subjektit datë 28.5.2020, në përgjigje të pyetësorit datë 8.5.2020.

²⁶Në përgjigje të pyetësorit standard.

e siguruara nga administrimi i ekonomisë bujqësore në blegtori dhe pemëtari; (vi) mbledhja e bimëve medicinale.

Komisioni verifikoi gjendjen civile të subjektit dhe familjarëve, bazuar në të dhënat e Zyrës së Gjendjes Civile²⁷, certifikatat familjare²⁸, si dhe shpjegimet e subjektit, ku evidentohet se:

- ka qenë me gjendje civile “beqar” deri në datën 30.5.2007 (data e lidhjes së martesës);
- në momentin e blerjes së apartamentit datë 14.1.2004, ka deklaruar²⁹ se ka banuar në Bulqizë, ku ka ushtruar funksionin si prokuror për periudhën 2000 – 2007;
- sipas certifikatës³⁰ familjare të lëshuar në datën 16.1.2020, nga Zyra e Gjendjes Civile Tropojë (mbi përbërjen familjare të periudhës 1991 – 2007), figuron me gjyshen Z.M (kryefamiljare) dhe vëllain S.M, i cili sipas shpjegimeve të subjektit ka jetuar me familjen e babait, duke dorëzuar të ardhurat e pagës së tij për vitet 1995 – 2004;
- sipas certifikatës familjare (mbi përbërjen e trungut familjar sipas regjistrimit themeltar të vitit 1974), të lëshuar në datën 22.12.2021, nga Zyra e Gjendjes Civile Tropojë, babai i subjektit R.M figuron në përbërje familjare me pjesëtarët, D.M (nëna) dhe A.M (vëllai).

Komisioni analizoi të gjitha burimet e deklaruara nga subjekti gjatë hetimit administrativ, si vijon:

1.3.1 Kontributi i subjektit nga paga si prokuror

Subjekti ka deklaruar³¹ se, në pjesën dërrmuese, të ardhurat e depozituara nga paga e tij si prokuror nga viti 1997 për babain ka qenë e vazhdueshme, i cili ka bërë administrimin e këtyre të ardhurave sipas nevojave të familjes, ku kjo shumë nga nëntori i vitit 1997 dhe deri në vitin 2004 ka qenë në vlerën 5.459.612 lekë. Lidhur me këto të ardhura, në dosje është administruar dokumentacioni vijues:

- vërtetim nr. ekstra prot., datë 16.10.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, mbi të ardhurat e shtetasit Hysni Mulaj për periudhën nëntor 1997 – nëntor 2000;
- vërtetim page e lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, për subjektin Hysni Mulaj për periudhën 1.1.2001 – 30.4.2007.

Në lidhje me burimin e shumës së dhënë hua dhe shumës dhuratë nga babai, në procesverbalin e datës 8.1.2016, të mbajtur në ILDKPKI³², subjekti ka deklaruar se një pjesë e mirë e këtyre të ardhurave janë edhe nga paga e tij si prokuror nga viti 1997 dhe duke qenë se ka banuar me prindërit, të ardhurat e tij i ka administruar babai. Ky kontribut ka vazhduar deri rreth vitit 2002.

Në analizën financiare janë konsideruar të ardhurat e subjektit deri në vitin 2002.

1.3.2 Të ardhurat nga aktiviteti i biznesit të babait R.M, në fshatin A, Tropojë

Subjekti ka deklaruar³³ se si burim të ardhurash për familjen e babait kanë qenë edhe të ardhurat e siguruara nga biznesi i tij i vogël në fshatin A, Tropojë, i cili ka filluar që nga viti 1996 e deri

²⁷Shkresë nr. *** prot., datë 2.12.2021.

²⁸Dokumentacioni i depozituar nga subjekti, në përgjigje të pyetësorit standard: certifikata familjare mbi përbërjen familjare për periudhën 1991 – 2007, e Zyrës së Gjendjes Civile Tropojë, lëshuar në datën 16.1.2020; certifikatë familjare e lëshuar në datën 21.10.2016 nga Zyra e Gjendjes Civile Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. *; certifikatë martesë, e lëshuar në datën 21.10.2016 nga Zyra e Gjendjes Civile Tiranë.

²⁹Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se për periudhën 2000 – 2007 ka banuar në ambientet e Prokurorisë së Rrethit Bulqizë.

³⁰Sipas certifikatës familjare të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Tropojë në datën 16.01.2020 (mbi përbërjen familjare për periudhën 11.2.1991 – 22.4.2007), të depozituar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit standard.

³¹Shpjegimet e subjektit datë 28.5.2020, në përgjigje të pyetësorit datë 8.5.2020.

³²Shkresë nr. *** prot., datë 10.12.2021.

³³Shpjegimet e subjektit me e-mail datë 28.5.2020, në përgjigje të pyetësorit datë 8.5.2020.

në vitin 2015, ku si aktivitet ka qenë shitja me pakicë e artikujve ushqimorë dhe industrialë, pastaj në një periudhë të mëvonshme është kthyer në bar-kafe.

Sipas shpjegimeve³⁴ të subjektit, ky biznes ka zhvilluar aktivitetin pa regjistrim në regjistrat e tatimeve, për shkak të situatës informale në zonë, ku aktiviteti zhvillohej në kushte informale dhe, për këtë arsye, është në pamundësi të provojë me dokument, kjo dhe për shkak të një periudhe shumë të hershme.

Lidhur me të ardhurat e këtij aktiviteti, subjekti ka depozituar dokumentacionin si në vijim:

- vërtetim nr. ** prot., datë 20.1.2020, i lëshuar nga Njësia Administrative Tropojë ku konfirmohet se babai i subjektit, z. R.M, banor i fshatit A, Tropojë, ka ushtruar aktivitet privat, shitje me pakicë të artikujve ushqimorë dhe industrialë, si dhe bar-kafe, nga periudha 1996 – 2015;
- vërtetim datë 14.1.2020, i lëshuar nga FSHU-ja, e cila konfirmon se z. R.M nuk është debitor për faturat e energjisë elektrike;
- vërtetim i OSHEE-së Dega Tropojë, e cila konfirmon se shtetasi R.M ka lidhur kontratë energjie elektrike (abonent private) në datën 28.1.2007;
- shkresë³⁵ nr. *** prot., datë 20.4.2022, e lëshuar nga Arkivi i Bashkisë Tropojë, e cila informon se nga rishikimi i dokumentacionit të dërguar nga ish-Komuna Tropojë, në emër të shtetasit R.I.M u gjendën 6 mandatearkëtime/pagesash, të kryera nga ky shtetas në vitet 1994,1995 dhe 1996 në Komunën Tropojë, (fshati A). Bashkëlidhur shkresës ndodhen mandatpagesat³⁶ përkatëse, të cilat janë nënshkruar nga shtetasi R.I dhe jo R.M (babai i subjektit).

Nga informacioni i dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës³⁷ ka rezultuar se shtetasi R. M (babai i subjektit) nuk rezulton i regjistruar si subjekt në Drejtorinë Rajonale Tatimore Kukës. Gjithashtu, QKB-ja³⁸ ka informuar se nuk rezulton aktivitet tregtar i regjistruar në emër të shtetasit R.M.

Komisioni ka kërkuar të dhëna mbi aktivitetin tregtar të shtetasit R.M (babai) pranë Njesisë Administrative të Bashkisë Tropojë, e cila ka informuar³⁹ se nga të dhënat dhe dokumentacioni i dorëzuar nga ish Komuna Tropojë, për fshatin A, si dhe kontakti me kryeplakun e fshatit, konfirmohet se shtetasi R.M ka pasur aktivitet tregtar (biznes të vogël) në Komunën Tropojë, fshati A, duke depozituar dokumentacionin si vijon:

- leja higjieno - sanitare me nr. ***, datë 4.10.1994, e lëshuar nga Inspektori Sanitar Shtetëror i Rrethit Tropojë, për objektin Njësi Ushqimore Tropojë (A), me fotografi të shtetasit R.M;
- mandatarckëtimi për pagesën e taksave vendore për vitet 2007, 2008 dhe 2009 (mandatarckëtimet: nr. **, datë 12.11.2009; nr. **, datë 23.8.2007; nr. *, datë 7.4.2008);
- libri i arkës (nëntor) datë 30.11.2009, i fragmentuar, ku në numrin rendor **, datë 12.11.2009, pasqyrohet biznesi i vogël në emër të shtetasit R.M dhe shuma e arkëtuar;
- ditari i arkës 2011 i biznesit të vogël, i fragmentuar, ku në numrin rendor ***, datë 14.12.2011, pasqyrohet zëri taksë biznesi i vogël për shtetasin R.M dhe kryer pagesa e taksës.

³⁴Shpjegimet e subjektit datë 28.5.2020, në përgjigje të pyetësorit datë 8.5.2020.

³⁵Depozituar nga subjekti gjatë hetimit shtesë regjistruar në Komision me nr. *** prot., datë 26.4.2022.

³⁶Mandatarckëtimet: nr. **, datë 2.6.1994; nr. **, datë 2.12.1994; nr. *, datë 3.2.1995; nr. **, datë 9.6.1995; dhe mandatpagesë nr. *, datë 23.4.1996; mandatpagesë nr. *, datë 9.5.1996, të arkëtuara nga shtetasi R.B.

³⁷Shkresë nr. *** prot., datë 23.11.2021.

³⁸Shkresë nr. *** prot., datë 23.7.2020.

³⁹Shkresë nr. *** prot., datë 20.12.2021.

Bashkia Tropojë ka informuar se dokumentacioni i dorëzuar nga ish-komunat është i mangët dhe jo i plotë në disa raste, për shkak të mosmbajtjes së dokumentacionit nga inspektorët e taksave dhe tarifave vendore pranë Komunës Tropojë.

Komisioni i kërkoi⁴⁰ subjektit të deklarojë dhe depozitojë dokumentacion mbi investime në pasuri të kryera nga babai, deri më momentin e dhënies së huas (në vitin 2004), për të cilën subjekti ka shpjeguar⁴¹ se nga informacioni i dhënë nga familjarët nuk rezulton që për periudhën kohore 1996 – 2004, të kenë kryer ndonjë investim në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme brenda dhe jashtë vendit.

Në lidhje me të ardhurat e babait nga aktiviteti i biznesit, Komisioni ka evidentuar mungesë dokumentacioni mbi të ardhurat e realizuara dhe pagesat e detyrimeve tatimore, për periudhën 1996 – 2004, e për rrjedhojë në analizën financiare nuk u përlogaritën këto të ardhura.

1.3.3 Të ardhurat nga pensioni i prindërve

Nga të dhënat e dërguara nga ISSH-ja⁴² evidentohet se babai i subjektit R.M ka përfitur pension pleqërie për periudhën prill 1997 – maj 2019, ndërsa nëna D.M përfiton pension pleqërie duke filluar nga tetori i vitit 1992.

Gjatë hetimit subjekti ka deklaruar⁴³ se të ardhurat nga pensioni i babait R.M për periudhën 1997 – 2005 kanë qenë në shumën 623.075 lekë dhe të ardhurat e pensionit të nënës D.M, për periudhën 1992 – 2004 kanë qenë në shumën 183.944 lekë.

Lidhur me këto të ardhura, subjekti ka dërguar⁴⁴ dokumentacionin si në vijim:

- vërtetim nr. ** prot., datë 22.1.2020, e ISSH Dega e Sigurimeve Tropojë, ku evidentohen të ardhurat e pensionit të shtetasit R.M për periudhën 1997 – 2019;
- vërtetim nr. ** prot., datë 12.5.2020, e ISSH Dega e Sigurimeve Tropojë, ku evidentohen të ardhurat e pensionit të nënës D.M për periudhën 1992 – 2004.

Komisioni ka konsideruar në analizë financiare të ardhurat nga pensionet e prindërve.

1.3.4 Të ardhurat e vëllait të subjektit A.M nga emigracioni në Belgjikë

Subjekti ka shpjeguar⁴⁵ se si burim tjetër i të ardhurave të babait ka qenë edhe kontributi i vazhdueshëm i vëllait emigrant në shtetin belg që nga viti 2000, ku më 3.2.2003 ka lidhur kontratë pune duke siguruar jo pak të ardhura dhe, konkretisht, 47.096 euro, ku një pjesë të konsiderueshme i ka dërguar në ndihmë të familjes babait R.M. Lidhur me të ardhurat e vëllait, subjekti ka depozituar⁴⁶ dokumentet provuese si në vijim:

- kontratë pune⁴⁷ (me kohëzgjatje të pacaktuar) datë 3.2.2003 për punësimin e z. A.M;
- vërtetim nga punëdhënësi, ku konfirmohet punësimi i z. A.M te biznesi “D.V.b.” (sh.p.k.), me kohëzgjatje të pacaktuar, ku të ardhurat nga paga *neto* për periudhën 2003 – 2005 janë në shumën 47.096 euro.

Nga hetimi i kryer, subjekti ka dokumentuar të ardhurat e ligjshme të vëllait nga punësimi në Belgjikë.

⁴⁰Pyetësori me e-mail datë 21.12.2021.

⁴¹Shpjegimet e subjektit me e-mail datë 28.12.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 21.12.2021.

⁴²Shkresë nr. *** prot., datë 14.7.2020.

⁴³Shpjegimet e subjektit me e-mail datë 28.5.2020, në përgjigje të pyetësorit datë 8.5.2020.

⁴⁴E-mail datë 28.5.2020.

⁴⁵Shpjegimet e subjektit me e-mail datë 28.5.2020, në përgjigje të pyetësorit datë 8.5.2020.

⁴⁶E-mail-i e datës 21.5.2020.

⁴⁷E përkthyer dhe e vulosur më 14.5.2020 nga një përkthyes holandisht - shqip, i betuar para Gjykatës së Shkallës së Parë në Gent, Belgjikë, akt i palegalizuar me vulë apostile (<https://sh.com/lajm/hiqet-legalizimi-i-dokumenteve-br-shqip-euml-ri-belgjik-euml-kursehen-20-euro>).

1.3.5 Të ardhurat e vëllait të subjektit S.M

Subjekti ka deklaruar⁴⁸ se si burim tjetër i të ardhurave për familjen e babait janë edhe të ardhurat e vazhdueshme nga paga e vëllait S.M, i cili ka jetuar me babain e subjektit dhe ka qenë i punësuar ne Policinë e Shtetit që nga viti 1995. Subjekti ka depozituar, gjithashtu, dokumentacion⁴⁹ provues mbi të ardhurat e vëllait, sipas të cilit për periudhën 1995 – 2004, vëllai ka siguruar të ardhura *neto* nga paga në shumën 2.518.668 lekë, të cilat janë depozituar në masën 100% në ekonominë e familjes së babait.

Lidhur me investime të kryera nga vëllezërit në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, në periudhën 1996 – 2004, subjekti ka shpjeguar⁵⁰, ndër të tjera, se vëllai S.M në datën 22.7.2003 ka blerë një sipërfaqe truall prej 300 m² dhe ndërtesë me sip. 54 m², me nr. pasurie ***, në Tropojë, përkundrajt shumës 300.000 lekë. Subjekti ka depozituar certifikatën e pronësisë dhe kontratën noteriale të shitblerjes⁵¹, ku dokumentohet blerja e kësaj prone nga shtetasi S.M.

Gjithashtu, subjekti ka depozituar⁵² shkresë me nr. *** prot., datë 30.12.2021, të lëshuar nga DPSHTRR-ja, e cila konfirmon se babai i subjektit dhe vëllezërit e tij nuk kanë pasur mjete të regjistruara në pronësi të tyre në periudhën 1996 – 2004.

Në analizën financiare janë përfshirë të ardhurat nga paga e vëllait për periudhën 1996 – 2003.

1.3.6 Të ardhurat nga ekonomia bujqësore, blegtorale, si dhe nga mbledhja e bimëve medicinale

a) Lidhur me të ardhurat nga ekonomia bujqësore

Subjekti ka shpjeguar⁵³ se këto të ardhura kanë qenë të konsiderueshme nga punimi i tokës arë me sip. 5.860 m² (e kultivuar me fasule dhe misër) dhe nga sipërfaqja e tokës 7.400 m² pemëtore (e mbjellë kryesisht me vreshta dhe gështenje), si dhe nga shitja e tepricave të këtyre prodhimeve dhe atyre të përpunuara (raki) në tregun lokal informal, duke siguruar një të ardhur vjetore mesatare në shumën 450.000 lekë. Në dosje është administruar dokumentacioni si në vijim:

- vërtetim nr. *** prot., datë 15.1.2020, i lëshuar nga ASHK-ja Tropojë, e cila konfirmon se shtetasi R.M ka në pronësi pasuri të paluajtshme, të fituara në bazë të AMTP-së nr. **, datë 10.1.1993, si dhe me formularë trojesh, konkretisht pasuritë: (i) nr. ***, “arë” me sip. 4.200 m²; (ii) nr. ***, “arë” me sip. 1.660 m²; (iii) nr. *** truall me sip. 300 m² dhe ndërtesë me sip.76 m²; (iv) nr. ***, truall me sip. 300 m² dhe ndërtesë me sip. 54 m²; (v) nr. ***, truall me sip. 300 m² dhe ndërtesë me sip. 250 m²; (vi) nr. ***, “pemëtore” me sip. 7.000 m²; (vii) nr. ***, “pemëtore” me sip. 4000 m²;
- vërtetim nr. *** prot., datë 28.5.2021, i Njësisë Administrative Tropojë, e cila ka konfirmuar se familja e shtetasit R.M, përfshirë bashkëpronarët dhe trashëgimtarët ligjorë, kanë fituar tokë bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, nga të cilat ka siguruar të ardhura vjetore në vlerë totale 166.800 lekë/vit. Ky koeficient i të ardhurave për metër katror është llogaritur në bazë të VKM-së nr. 1053, datë 23.4.2008;

⁴⁸Shpjegimet e subjektit me e-mail datë 28.5.2020, në përgjigje të pyetësorit datë 8.5.2020.

⁴⁹Dokumentacion i depozituar nga subjekti me e-mail, datë 21.5.2020, lidhur me të ardhurat e vëllait S.M: vërtetim nr. *** prot., datë 31.3.2020, i lëshuar nga Komisarati i Policisë Tropojë; vërtetim për bazën e vlerësueshme nr. ** prot., datë 30.3.2020, të Komisarati të Policisë Tropojë për të ardhurat e z. S.M në periudhën prill 1996 – dhjetor 1998; vërtetim për bazën e vlerësueshme nr. ** prot., datë 30.3.2020, të Komisarati të Policisë Tropojë, për të ardhurat e z. S.M në periudhën janar 1999 – dhjetor 2002; vërtetim për bazën e vlerësueshme nr. ** prot., datë 30.3.2020, të Komisarati të Policisë Tropojë, për të ardhurat e z. S.M në periudhën janar 2003 – dhjetor 2004 (përfshirë periudhën janar 2004 – qershor 2004).

⁵⁰Shpjegimet e subjekti me e-mail datë 28.12.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 21.12.2021.

⁵¹Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 22.7.2003.

⁵²E-mail datë 14.1.2022.

⁵³Shpjegimet e subjektit me e-mail datë 28.5.2020 në përgjigje të pyetësorit datë 8.5.2020.

- nga informacioni i ardhur nga ASHK-ja Tropojë⁵⁴ ka rezultuar se në emër të shtetasit R. M (babai i subjektit) janë të regjistruara shtatë pasuri⁵⁵ të paluajtshme, të llojit “tokë arë” me sip. 4.200 m² dhe 1.660 m², dy pemëtore me sip. 4.000 m² dhe 7.000 m², si dhe tri pasuri të llojit “truall + ndërtesë” me sipërfaqe trualli 300 m² dhe ndërtesa me sip. 54 m², 76 m² dhe 250 m², pasuri të përfituara kryesisht me ligjin nr. 7501 dhe formularë trojesh.

b) Të ardhurat nga administrimi i ekonomisë blegtorale

Subjekti ka shpjeguar⁵⁶ se si burim tjetër i të ardhurave për familjen e babait kanë qenë edhe të ardhurat e siguruar nga mbarështimi i gjësë së gjallë (dele dhe lope), ku janë siguruar të ardhura të vazhdueshme nga shitja e bulmetit dhe gjësë së gjallë (qingja dhe viça). Sipas subjektit, nga shitja e tyre në tregun informal është siguruar një e ardhur vjetore në masën 300.000 lekë/vit. Për të provuar këto të ardhura, subjekti ka depozituar⁵⁷ dokumentacionin si vijon:

- vërtetim nr. *** prot., datë 27.5.2021, të lëshuar nga Njësia Administrative Tropojë, e cila në bazë të deklarimeve të bëra nga bashkëpronarët dhe trashëgimtarët ligjorë, vërteton se familja e z. R.M, banor i fshatit A, ka siguruar të ardhura ekonomike vjetore nga blegtoria në pronësi të tyre në vlerë totale 270.000 lekë/vit. Ky koeficient i të ardhurave nga blegtoria është llogaritur në bazë të VKM-së nr. 1053, datë 23.4.2008.

c) Të ardhurat nga mbledhja e bimëve medicinale

Subjekti ka shpjeguar⁵⁸ se si burim tjetër i të ardhurave për familjen e babait është edhe mbledhja në kohën e sezonit të verës të bimëve medicinale, kryesisht boronicës, ku sipas subjektit nga shitja e saj në tregun informal është siguruar një e ardhur vjetore në masën 400.000 lekë.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se subjekti nuk ka provuar të ardhurat e realizuara nga ekonomia bujqësore, blegtorale, si dhe nga mbledhja e bimëve medicinale, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, këto të ardhura nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni.

1.4 Shpenzimet e mobilimit të apartamentit

⁵⁴Shkresë nr. *** prot., datë 13.12.2021, ZV ASHK Tropojë ka dërguar dokumentacionin si më poshtë: aplikim/kërkesë për regjistrimin dhe lëshimin e certifikatës datë 19.7.2012, për pasurinë nr. *** në emër të shtetasit R.M; hartë treguese dhe kartelë e pasurisë së paluajtshme nr.***, e lëshuar në datën 10.9.2012; procesverbal i mbajtur në datën 19.7.2012 nga ZAMT në ZVRPP; shkresë nr. *** prot., datë 19.7.2012, e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Zyra Tropojë; vendim nr. **, datë 17.6.2008, i Komisionit të Ndarjes së Tokës, fshati A (modelari nr. 4); AMTP-ja nr. *** në emër të shtetasit R.M, shoqëruar me kartelën e parcelave; plan vendosje e pasurisë nr. **, e lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës; certifikatë familjare e lëshuar në datën 11.6.2012 nga Zyra e Gjendjes Civile Komuna Tropojë, fshat (përbërjen familjare më 1.8.1991); letërnjoftim i shtetasit R.M; aplikim kërkesë për regjistrimin dhe lëshimin e certifikatës datë 19.7.2012, për pasurinë nr. *** në emër të shtetasit R.M; harta treguese dhe kartelë e pasurisë së paluajtshme me nr. **, lëshuar në datën 10.9.2012; lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive, fshati Tropojë për pasurinë nr. *** (truall me sip. 300 m² dhe ndërtesë me sip. 76 m²), pasurinë nr. *** (truall me sip. 300m² dhe ndërtesë me sip. 54 m²) dhe pasurinë nr. *** (truall me sip. 300m² dhe ndërtesë me sip. 250 m²); AMTP-ja nr. **, datë 10.1.1993 në emër të shtetasit R.M.

⁵⁵Pasuria nr. **, arë me sip. 4.000 m² sipas aktit dhe sip. 4.200 m² sipas matjeve faktike, e fituar me AMTP-në nr. **, datë 10.1.1993; pasuria nr. **, arë me sip. 410 m² sipas aktit nr. ** dhe sip. 1.660 m² sipas matjeve faktike, të fituara me AMTP-në nr. **, datë 10.1.1993; pasuria nr. **, truall me sip. 300 m² dhe ndërtesë me sip. 54 m², e fituar me formularë trojesh; pasuria nr. **, truall me sip. 300 m² dhe ndërtesë me sip. 76 m², e fituar me formularë trojesh; pasuria nr. **, truall me sip. 300 m² dhe ndërtesë me sip. 250 m², e fituar me formularë trojesh (nuk është pajisur me certifikatë pronësie); pasuria nr. **, pemëtore me sip. 4.000 m², e fituar me AMTP-në nr. **, me vendim nr. **, datë 17.6.2008, të Komisionit të Ndarjes së Tokës; pasuri nr. **, pemëtore me sip. 7.000 m², e fituar me AMTP-në nr. **, me vendimin nr. **, datë 17.6.2008, të Komisionit të Ndarjes së Tokës.

⁵⁶Shpjegimet e subjektit me e-mail datë 28.5.2020, në përgjigje të pyetësorit datë 8.5.2020.

⁵⁷E-mail datë 14.1.2022.

⁵⁸Shpjegimet e subjektit me e-mail, datë 28.5.2020 në përgjigje të pyetësorit datë 8.5.2020.

Në lidhje me shpenzimet e mobilimit të apartamentit, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka shpjeguar se mobilimi i shtëpisë është bërë gradualisht brenda një afati prej dy 2 vjetësh, pasi në atë kohë ka qenë i punësuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Bulqizë dhe në Tiranë shkonte vetëm në fundjavë ose në ndonjë rast mbledhjeje gjatë javës dhe vlera e përafërt e mobilimit nuk e kalon në total shumën 1.000.000 lekë.

Gjatë hetimit, në përgjigje të pyetësorit datë 8.5.2020, subjekti ka shpjeguar⁵⁹ se mobilimi i banesës është bërë gradualisht, i shtrirë në 2-3 vite, kjo për faktin se gjatë kohës së blerjes së apartamentit nuk kishte nevojë urgjente për banim.

Nga hetimi ka rezultuar mospërputhje deklarimesh lidhur me shpenzimet e mobilimit, pasi nuk është saktësuar periudha e kryerjes së këtyre shpenzimeve.

1.4.1 Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit

Në prapësimet e datës 26.5.2022, subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se në përpjekje për të saktësuar momentin kur i ka kryer këto blerje, kujton se vlera e përafërt e mobilimit ka qenë rreth 320.000 lekë në vitin 2004, ku këto mobilime janë porositur dhe paguar në fund të vitit 2004, nga kursimet e pagës së vitit 2004 dhe i ka përfunduar në vitin 2007, i cili përkon me vitin kur ka filluar të banojë në Tiranë.

1.4.2 Vlerësimi i Komisionit

Lidhur me shpenzimet e mobilimit të apartamentit, subjekti saktësoi se vlera e përafërt e mobilimit në vitin 2004 ka qenë rreth 320.000 lekë, mobilim i porositur dhe paguar në fund të vitit 2004, i përfunduar në vitin 2007, vit ky që përkon me vitin kur ka filluar të banojë në Tiranë. Nisur nga fakti se llogaritja e këtyre shpenzimeve është kryer nga Komisioni apriori i ndarë midis viteve 2006, 2007 dhe 2008, për shkak se gjatë hetimit subjekti nuk mundi të përcaktonte një periudhë konkrete në të cilën është kryer mobilimi, Komisioni, në mungesë të një prove të kundërt, çmon të konsiderojë këtë pretendim të subjektit, duke rillogaritur shpenzimet e mobilimit në analizë financiare.

1.5 Analiza financiare

Nga analizimi i dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, si dhe të depozituar nga subjekti, Komisioni kreu një analizë financiare për të vlerësuar mundësinë e dhënies së shumës 4.000.000 lekë nga babai, me burime të ligjshme për periudhën 1995 – 2003, ku janë marrë në konsideratë:

- të ardhurat nga pensioni i babait për periudhën 1997 – 2003;
- të ardhurat nga pensioni i nënës për periudhën 1996 – 2003;
- të ardhurat nga paga e subjektit për periudhën 1997 – 2002;
- të ardhurat nga paga e vëllait S. M. për periudhën 1996 – 2003;
- të ardhurat nga paga e vëllait A. M. në Belgjikë për periudhën 2003 – 2005;
- shpenzimet e jetesës së subjektit, prindërve dhe vëllait në Shqipëri për periudhën 1995 – 1999 janë përlllogaritur në masën 66% të të ardhurave⁶⁰;
- shpenzimet jetike për periudhën 2000 – 2003 janë përlllogaritur sipas ILDKPKI-së, duke i zbritur rreth 50%, pasi familja e subjektit ka pasur mundësi të sigurojë shportën ushqimore nga përdorimi i tokës bujqësore;
- shpenzimet jetike për vëllain e subjektit në Belgjikë janë përlllogaritur sipas EUROSTAT-it⁶¹;

⁵⁹Shpjegimet e subjektit me e-mail, datë 28.5.2020, në përgjigje të pyetësorit datë 8.5.2020.

⁶⁰Referuar vendimit nr. 18, datë 26.7.2018, për subjektin N. K, të Kolegjit.

⁶¹<https://appsso.eurostat.ec.europa.eu>

- në analizë është përfshirë edhe investimi në shumën 300.000 lekë të blerjes së pasurisë tokë dhe ndërtesë nga shtetasi S. M. në vitin 2003.

1.5.1 Konstatime të Komisionit

Nga analiza e kryer ka rezultuar se të ardhurat familjare kanë qenë të mjaftueshme për dhënien e huas në vitin 2004, por babai nuk ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme për dhuratën, pasi në vitin 2005 rezulton me balancë negative në shumën 470.398 lekë. E për pasojë subjekti ka rezultuar me këtë balancë negative për pagesën e kështit të tretë.

Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikë 5, të nenit D, të Kushtetutës.

1.6 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në prapësime të rezultateve të hetimit lidhur me të ardhurat nga aktiviteti i biznesit familjar (biznes i vogël) të babait të subjektit, në datën 18.3.2022, subjekti ka depozituar dokumentacionin, si vijon:

- aktekspertimin për llogaritjen e të ardhurave nga aktiviteti i biznesit të babait, me metoda të tjera alternative, nga data e fillimit të aktivitetit 3.1.1994 deri më 31.12.2009⁶² (bashkëlidhur aktekspertimit ndodhet dokumentacioni⁶³ përkatës në bazë të të cilave është përgatitur ky akt);
- vërtetimin nr. ** prot., datë 11.3.2022, i lëshuar nga Ujësjetës Kanalizime Tropojë, e cila konfirmon se nuk ka pasur rrjet për shpërndarje ujë të pijshëm në Komunën Tropojë, fshati A, për periudhën 1994 – 2004.

Në prapësimet e depozituara në datën 18.3.2022, subjekti ka shpjeguar se burimi i të ardhurave të vetme për blerjen e apartamentit janë huaja e marrë nga babai (i ndjeri R.M), ku përfshihen të gjitha të ardhurat e familjarëve të deklaruara prej tij gjatë hetimit, si dhe të ardhurat e pagës së tij, të cilat kanë vazhduar edhe pas vitit 2002, duke kërkuar për llogaritjen e të ardhurave nga paga e tij deri në vitin 2004.

Lidhur me aktivitetin e biznesit të babait, subjekti ka shpjeguar se ekzistenca e këtij aktiviteti konfirmohet nga autoritetet lokale bazuar në vërtetimin e depozituar prej tij, si dhe kontrata me OSHE-në e lidhur si abonent jo familjar (biznes). Subjekti ka pranuar mungesën e dokumentacionit në lidhje me të ardhurat dhe një pjesë e pagesave të detyrimeve tatimore, duke shpjeguar se ruajtja e tyre nuk është përgjegjësi e tij dhe babait që ka biznesin, por është përgjegjshmëri e institucioneve vendore dhe lokale, të cilat nuk kanë mbajtur regjistër dhe as dokumentacion të saktë të bizneseve, të të ardhurave të realizuara prej tyre, si dhe pagesën e detyrimeve (taksave). Sipas subjektit, babai i tij ka pasur korrektësi maksimale në pagesën e çdo detyrimi vendor mujor e vjetor dhe ka ngritur një biznes familjar me shumë vështirësi, në një zonë të thellë malore.

⁶²Sipas këtij aktekspertimi, të ardhurat për aktivitetin “bar-kafe” janë 57.460.000 lekë, shpenzimet janë 22.667.840 lekë dhe fitimi i mbetur *neto* për këtë periudhë është 37.792.160 lekë. Ndërsa, të ardhurat totale *neto* të për llogaritura nga Njësia Tregtare e “Shitje me pakicë e artikujve ushqimorë dhe industrialë ” janë në shumën 9.000.000 lekë.

⁶³Leje higjieno-sanitare, datë 4.10.1994, për objektin “Njësi ushqimore Tropojë”; vërtetim nr. ** prot., datë 20.1.2020, i lëshuar nga Njësia Administrative Tropojë; vërtetim i lëshuar nga OSHE, dega Tropojë; tri mandatar-këtime për pagesën e taksës së regjistrimit të biznesit në vitet 2007, 2008 dhe 2009 dhe kopje e Librit të Arkës, datë 30.11.2009; certifikatë pronësie, datë 19.1.2004, dhe kartelë pasurie nr. **, të llojit “truall” me sip. 300 m² dhe ndërtesë me sip. 76 m², në pronësi të shtetasit R. M, të ndodhur në A, Tropojë; certifikatë me numër amze ***, e lëshuar në datën 8.6.2015 nga Instituti i Ekspertëve Fiskalë për ekspertin A.Ç; licencë profesionale individuale nr. regj. *** dhe certifikatë regjistrimi i personit të tatueshëm në emër të “A.Ç”, person fizik.

Për sa më sipër, subjekti kërkoi që të merren në konsideratë të ardhurat nga aktiviteti i biznesit të babait për periudhën 1994 – 2003 dhe në rast të mos marrjes në konsideratë të këtyre të ardhurave, kërkoi që Komisioni minimalisht të marrë në konsideratë si të ardhur një pagë mujore të babait si i vetëpunësuar në këtë biznes për periudhën 1994 – 2003.

Sa i përket dërgesave të të ardhurave nga vëllai në Belgjikë pranë familjes, subjekti, në prapësimet e tij datë 18.3.2022, ka shpjeguar se këto të ardhura janë dërguar nëpërmjet W.U, të afërme dhe të njohurve, por për shkak të kohës së gjatë nuk është bërë e mundur të sigurohet ndonjë dokument vërtetues.

Lidhur me të ardhurat e realizuara nga ekonomia blegtorale dhe bujqësore, subjekti ka argumentuar se ato janë bindshëm të provuara dhe, si të tilla, duhet të konsiderohen të ligjshme, pasi jetesa në fshat është e lidhur pazgjidhshmërisht me bujqësinë e blegtorinë dhe deklarimi i tyre është kryer për t'u marrë në konsideratë si e ardhur nga ekonomia familjare dhe jo si e ardhur e siguruar nga biznes familjar (fermë blegtorale apo bujqësore etj.).

Pas hetimit shtesë, përmes prapësimeve të datës 26.5.2022, subjekti ka shpjeguar se pasuritë e paluajtshme në emër të babait R.M janë përdorur nga familja për prodhime bujqësore dhe blegtorale të ndryshme për jetesë, ku nga kultivimi i sipërfaqeve të tokës arë prej 5.860 m² dhe pemëtoresh prej 7.400 m², si dhe nga shitja e tepricave të këtyre prodhimeve dhe atyre të përpunuara (raki) në tregun informal, kanë siguruar të ardhura të ligjshme në zbatim të legjislacionit për të ardhurat bujqësore dhe blegtorale.

Subjekti pretendon se, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, të ardhurat e realizuara nga të vetëpunësuarit në bujqësi apo shitësit ambulantë, nuk konsiderohen si të ardhura të tatueshme. Ndërsa, në pikën 11 të nenit 8/1 të po këtij ligji përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat të ardhurat e realizuara nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore nga një person fizik ose juridik që kryen aktivitet bujqësor.

Sipas subjektit, të vetëpunësuarit në bujqësi nuk kanë pasur detyrimin të regjistroheshin si tregtarë dhe as të pajiseshin me leje të posaçme për shitjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale, që buronin nga shfrytëzimi i tokës bujqësore, të përfituar me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”.

Subjekti kërkoi që Komisioni të mbajë të njëjtin qëndrim njëloj me disa vendimmarrje⁶⁴ që kanë marrë formë të prerë, ku janë konsideruar të ardhurat nga toka bujqësore, duke theksuar se shpenzimet e jetesës së këtyre familjeve për shkak të ekonomisë bujqësore janë më të ulëta.

Lidhur me mundësitë financiare të babait për dhënien e huas dhe dhuratës, përmes prapësimeve të datës 26.5.2022, subjekti pretendoi se analiza financiare e kryer nga Komisioni nuk i përket situatës financiare të babait për dhënien e huas në vitin 2004 dhe dhuratës në vitin 2005.

Këtë pretendim subjekti e bazoi në analizën financiare të paraqitur prej tij, mbi mundësitë financiare të familjes së babait për periudhën 1996 – 2004, ku në analizë ka konsideruar: (i) të ardhurat nga blegtoria në vlerën 270.000 lekë/në vit; (ii) të ardhura vjetore nga ekonomia bujqësore në vlerën totale 166.800 lekë/vit; (iii) të ardhurat nga emigracioni i vëllait (6.386 euro/vit në vitet 2003 dhe 2004); si dhe (iv) shpenzimet e jetesës të llogaritura me 50% të standardit të shpenzimeve të jetesës (mbi të ardhurat nga pagat dhe pensionet), pasi familja ka jetuar në fshat dhe produktet për konsum përballoheshin nga prodhimet bujqësore e blegtorale të familjes.

Sipas subjektit, nëse në analizë do të përfshihen të ardhurat nga prodhimet bujqësore e blegtorale, si dhe të ardhurat nga aktiviteti privat i babait, do të rezultonte se ky i fundit ka

⁶⁴Vendimet: nr. ***, datë 4.2.2020, i Komisionit (pika 3.39); nr. ***, datë 28.1.2020 (pika 6.4); nr. ***, datë 26.2.2020 (pika 24.8.10); nr. ***, datë 22.4.2021; nr. ***, datë 26.7.2019; nr. ***, datë 8.10.2021.

pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për kursime, ku në fund të vitit 2003 do të rezultonte me një bilanc pozitiv në shumën 23.132.035 lekë, nga të cilat subjektit i ka dhënë huan prej 4.000.000 lekësh dhe në fund të vitit 2004 shumën 22.310.786 lekë.

Subjekti argumentoi se edhe nëse Komisioni nuk i merr në konsideratë të ardhurat nga aktiviteti privat i ushtruar nga babai si person fizik, përsëri në fund të viteve 2003 dhe 2004 do të rezultonte me bilance pozitive, ku babai ka pasur mundësi financiare për të dhënë hua dhe dhuratë.

Referuar analizës financiare të paraqitur nga subjekti me prapësimet e datës 26.5.2022, për periudhën 2004 – 2005, subjekti pretendoi se shpenzimet jetike për vitet 2003, 2004, 2005 dhe 2006 i janë llogaritur nga Komisioni për dy persona, ndërsa në llogaritjen e të ardhurave ka përfshirë vetëm të ardhurat e subjektit dhe jo të vëllait të tij S.M, ndërkohë që subjekti në këtë periudhë, duke qenë i punësuar në Bulqizë, ka jetuar vetëm, megjithëse ka qenë në një trung familjar me gjyshen dhe vëllain.

Në përfundim të prapësimeve të tij, subjekti pretendon se nga analiza financiare e paraqitur prej tij, duke marrë në konsideratë huan e marrë nga babai, ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për pagesën e kësteve për blerjen e apartamentit në vitin 2004 dhe në shkurt të vitit 2005, duke rezultuar me balancë pozitive.

1.7 Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, në mbështetje të deklarimeve të subjektit, prapësimeve të tij, si dhe dokumentacionit të administruar në dosje, vlerëson se subjekti arriti të provojë përmes provave indirekte ekzistencën e aktivitetit të biznesit të vogël të ushtruar nga babai nga viti 1994 deri në vitin 2015, por nuk ka mundur të provojë me dokumentacion justifikues të ardhurat e ligjshme të gjeneruara nga ky aktivitet, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga administrimi i ekonomisë bujqësore, blegtorale dhe shitja e bimëve medicinale, nga hetimi administrativ rezultoi i provuar zotërimi i tokës bujqësore nga personi tjetër i lidhur (babai), përfituar me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, por subjekti nuk arriti të provojë pagesën e taksës për tokën bujqësore, si dhe pagesën e kontributeve përkatëse nga babai si i vetëpunësuar në bujqësi (sipas përcaktimeve në nenin 9 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”), duke mos qenë në kushtet e ligjit që rregullon aktivitetin e të vetëpunësuarit në bujqësi (fermerit).

Komisioni çmon se të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral mbeten në nivel deklarativ dhe të paprovuara me dokumentacion ligjor, pasi të dhënat e prezantuara në aktet e lëshuara nga Njësia Administrative Tropojë⁶⁵ nuk provojnë të ardhurat faktike të realizuara nga bujqësia dhe blegtoria, në funksion të detyrimit që ka subjekti i rivlerësimit në këtë proces për të provuar me dokumentacion të ardhurat e ligjshme të babait të tij, si person tjetër i lidhur. Për rrjedhojë, këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizën financiare, por duke qenë se produktet e përfituara nga kultivimi i tokës bujqësore dhe blegtoria kanë shërbyer për konsum familjar, Komisioni çmoi të drejtë pretendimin e subjektit për uljen e shpenzimeve jetike në masën 50% për familjen e tij.

Gjithashtu, trupi gjykues vlerësoi të drejtë pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizë financiare të shpenzimeve jetike për një person në vitet 2003, 2004, 2005 dhe 2006, të cilat i janë llogaritur për dy persona, pasi nga hetimi i kryer ka rezultuar se në këtë periudhë subjekti ka jetuar vetëm, duke qenë i punësuar në Prokurorinë e Rrethit Bulqizë.

⁶⁵Vërtetim nr. *** prot., datë 28.5.2021, dhe vërtetim nr. *** prot., datë 27.5.2021, e lëshuar nga Njësia Administrative Tropojë.

Në përfundim, trupi gjykues, duke marrë në konsideratë të gjitha konstatimet e arsyetuara sa më sipër, të cilat passjellin pamundësi financiare për të justifikuar plotësisht me burime të ligjshme blerjen e apartamentit, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në raport edhe me deklaratimet e tjera që lidhen me kriterin e pasurisë, vlerëson se balanca negative e rezultuar nga analiza është në një masë të tillë që, duke qëndruar edhe si një shkak i vetëm, proporcionalisht çmohet si e pamjaftueshme për të çuar subjektin drejt aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

2. Tokë arë⁶⁶ me sip. 200 m², në Tropojë, përfituar në bazë të ligjit nr. 7501, si anëtar i familjes bujqësore

Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka kërkuar informacion pranë ASHK-së Tropojë⁶⁷, e cila ka konfirmuar se në emër të z. Hysni Mulaj është e regjistruar në regjistrin pasurive të paluajtshme të fshatit A, Tropojë, z. k. ***, pasuria e llojit “arë” me nr. ***, me sip. 400 m² sipas aktit, ndërsa sipas matjeve faktike me sip. 200 m², për të cilën nuk është aplikuar për pajisje me certifikatë pronësie. Bashkëlidhur shkresës ndodhet AMTP-ja nr. **, datë 20.12.1992, në emër të z. Hysni Mulaj.

Nga verifikimi i kryer nga Komisioni është evidentuar se subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratimet periodike ndër vite. Komisioni i ka kërkuar⁶⁸ subjektit të shpjegojë arsyen e mosdeklarimit të kësaj pasurie në deklaratimet periodike vjetore, për të cilën subjekti ka shpjeguar⁶⁹ se: *“Sasia e tokës arë 200 m² dhe 400 m², e regjistruar në zonën kadastrale nr. ***, Bashkia Tropojë, është tokë e përfituar në bazë të ligjit nr. 7501, si anëtar i familjes bujqësore. Arsyet e mosdeklarimit të kësaj sipërfaqeje toke në deklaratat periodike ka qenë fakti se unë nuk kam marrë dijeni se kjo tokë ishte regjistruar në regjistrat kadastralë, pasi fizikisht unë nuk kam jetuar me prindërit e mi për shkak të detyrës si prokuror në rrethe dhe kjo ka qenë thjesht neglizhencë e babait tim në kohën kur ka bërë regjistrimin dhe nuk ka qenë aspak qëllimi për ta fshehur. Në datën 8.1.2016, unë nga ana e ILDKPKI-së jam vënë në dijeni të informacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Tropojë. Menjëherë pas kësaj, dhe konkretisht në datën 20.1.2016, kam dorëzuar pranë ILDKPKI-së gjithë dokumentacionin në lidhje me burimin e kësaj prone”*.

Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues:

- vërtetimin nr. *** prot., datë 21.1.2016, sipas të cilit z. Hysni Mulaj ka në pronësi pasurinë arë me sip. 400 m²;
- vërtetimin nr. *** prot., datë 17.10.2016, sipas të cilit z. Hysni Mulaj ka në pronësi pasurinë arë me sip. 200 m².

Në lidhje me mospërputhjen e sipërfaqes së pronës nga 400 m² në 200 m², subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar⁷⁰ se lidhur me këtë mospërputhje i është referuar shkresave zyrtare të lëshuara nga ZVRPP-ja Tropojë, të cilat e kanë çorientuar, pasi kanë lëshuar dy vërtetime ku njëri prej tyre konfirmon pronësinë për 400 m² dhe vërtetimi tjetër konfirmon pronësinë për 200 m².

Nga verifikimi i akteve të administruara evidentohet se sipërfaqja e kësaj prone është saktësuar nga ASHK-ja në bazë të matjeve faktike të kryera dhe, për rrjedhojë, nuk evidentohen problematika.

⁶⁶Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: vërtetimin nr. *** prot., datë 17.10.2016, lëshuar nga ZVRPP-ja Tropojë, ku vërtetohet se z. Hysni Mulaj ka në pronësinë e tij 200 m² tokë arë në z. k. ***, përfituar nga ligji nr. 7501.

⁶⁷Me shkresën nr. *** prot., datë 24.11.2021.

⁶⁸Përmes pyetësorit me e-mail datë 8.5.2020.

⁶⁹Shpjegimet e subjektit, datë 28.5.2020, në përgjigje të pyetësorit datë 8.5.2020.

⁷⁰Shpjegimet e subjektit me e-mail datë 28.12.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 21.12.2021.

Nga hetimi i kryer deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

3. Automjet⁷¹ në përdorim, në pronësi të shtetasit B.N/vëllai i bashkëshortes, blerë në vitin 2012, në shumën 6.000 euro + shpenzime zhdoganimi në shumën 171.219 lekë.

3.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

Komisioni ka kërkuar informacion pranë institucioneve përkatëse, si vijon:

DPSHTRR-ja⁷² ka konfirmuar se z. Hysni Mulaj dhe bashkëshortja e tij nuk kanë automjete të regjistruara në pronësi të tyre.

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit⁷³ ka informuar se z. Hysni Mulaj dhe bashkëshortja e tij nuk kanë automjet në pronësi të tyre, por disponojnë leje drejtimi të kategorisë “B”, ndërsa shtetasi B.N ka tre mjete⁷⁴ në pronësi të tij.

3.1.1 Nga hetimi i kryer nga Komisioni, referuar dosjes së mjetit⁷⁵ me targa AA ***EF, të administruar nga DPSHTRR-ja⁷⁶, ka rezultuar se në datën 29.6.2012 shtetasi B.N ka blerë në Gjermani automjetin tip “D.C”, me vit prodhimi 2004, në vlerën 6.000 euro, zhdoganuar në datën 5.7.2012, me vlerë zhdoganimi 171.219 lekë. Ky automjet është regjistruar në pronësinë e z. N në datën 6.7.2012.

Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar⁷⁷ se që nga viti 2012 ka përdorur automjetin në pronësi të kumatit të tij B.B.N (referuar autorizimit nr. *** rep., datë 10.8.2012), të cilin kryesisht e ka përdorur dhe vazhdon ta përdorë për disa udhëtime jashtë qytetit të Tiranës, kryesisht në Tropojë, i cili bëhet tranzit nga shteti i Kosovës.

Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues një autorizim noterial me nr. *** rep., datë 10.8.2012, përmes së cilës shtetasi B.N ka autorizuar z. Hysni Mulaj që të qarkullojë me këtë automjet brenda dhe jashtë vendit, për një periudhë njëvjeçare, duke pasur detyrimin që ta kthejë mjetin në gjendjen që e ka marrë në dorëzim me mbarimin e afatit.

3.1.2 Nga të dhënat e gjeneruara nga sistemi i AMF-së, ka rezultuar se: (i) shtetasi B.N është shënuar “pronar” në policat e sigurimit të mjetit TPL, duke filluar nga data 6.7.2012 deri aktualisht; (ii) subjekti i rivlerësimit Hysni Mulaj është shënuar “përdorues” në policat e sigurimit të mjetit TPL, duke filluar nga data 5.7.2013 (polica e sigurimit të vitit të parë me nr. ***) dhe për vitet në vijim deri aktualisht; (iii) bashkëshortja e subjektit R.M figuron “përdoruese” në policat e sigurimit të mjetit TPL në periudhat 5.7.2013 – 4.7.2014, 15.7.2014 – 14.7.2015 dhe 18.8.2017 – 17.8.2018.

3.1.3 Nga kërkimi i kryer në sistemin e AMF-së, me të dhënat e shtetasit B.N, ka rezultuar se ky shtetas, përveç automjetit dhënë në përdorim subjektit, figuron: (i) pronar i mjetit me targa

⁷¹Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: certifikatë e pronësisë së mjetit rrugor me targa AA *** EF, në emër të shtetasit B. N.N; autorizim datë 10.8.2012 nga shtetasi B.N, për përdorimin e automjetit me targa AA *** EF për një periudhë njëvjeçare.

⁷²Shkresë nr. *** prot., datë 21.7.2020.

⁷³Shkresë *** prot., datë 24.11.2021.

⁷⁴Automjeti tip “Volkswagen” me targa BB *** SA; automjeti tip “D. C” me targa AA *** EF; automjeti tip “Mercedes Benz” me targa AA *** PD.

⁷⁵Leja e qarkullimit rrugor datë 6.7.2012, në emër të shtetasit B. N; shkresë nr. *** prot., datë 27.3.2018 e DPSHTRR-së drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë; certifikatë e kontrollit fizik të mjetit datë 6.7.2012; letërnjoftim i shtetasit B.N; urdhër çlirim (faturë nr. ***) datë 5.7.2012, e Drejtorisë së Përgjithshme të doganave; deklaratë zhdoganimi; kontratë blerje automjeti (në gjuhën gjermane);

⁷⁶Shkresë nr. *** prot., datë 26.11.2021.

⁷⁷Në përgjigje të pyetësorit standard.

AA *** PD nga viti 2016 dhe në vijim (polica e sigurimit të vitit të parë me datë 27.12.2016); si dhe (ii) përdorues i tre automjeteve⁷⁸, kryesisht i automjetit të babait të tij B.N.

3.1.4 Nga informacioni i ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit⁷⁹ lidhur me masa administrative (gjoha) të vendosura mbi mjetet, nuk u evidentuan të dhëna që lidhen me subjektin e rivlerësimit apo pronarin e tij B. N.

3.1.5 Nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS⁸⁰, ka rezultuar se: (i) subjekti i rivlerësimit Hysni Mulaj dhe bashkëshortja R.M kanë përdorur automjetin për udhëtime të kryera jashtë vendit, në mënyrë të vazhdueshme nga viti 2012 dhe në vijim, kryesisht në pikën kufitare të Qafë-Morinës; (ii) pronari i mjetit B.N figuron të ketë dalë me këtë automjet jashtë territorit të Shqipërisë vetëm një herë, në datën 15.3.2014.

3.1.6 Nga hetimi i kryer në website-n⁸¹ mbi shitjen e automjeteve të përdorura, ka rezultuar se ky automjet është publikuar për shitje nga një person i regjistruar si pronari i saj, me emrin e subjektit dhe numrin e telefonit i cili përkon me numrin e kontaktit të deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*. Në website ndodhen edhe pamje fotografike të automjetit dhe targës së tij.

3.1.7 Komisioni i ka kërkuar⁸² subjektit të depozitojë faturat e pagesave të kryera nga kunati për blerjen e automjetit, si dhe të provojë edhe lidhjen familjare me këtë shtetas, për të cilën subjekti ka shpjeguar⁸³ se nga biseda e kryer me kunatin, këtë automjet e ka porositur *online* në Gjermani dhe pagesa do të kryhej kur mjeti të mbërrinte në Shqipëri. Në momentin që ka marrë automjetin ka bërë pagesën *cash*, pa ndonjë faturë apo mandatpagesë.

3.2 Lidhur me mundësitë financiare të shtetasit B.N për blerjen e automjetit

3.2.1 Komisioni i ka kërkuar⁸⁴ subjektit të depozitojë dokumentacion justifikues për të provuar mundësinë financiare të vëllait të bashkëshortes B.N për blerjen e automjetit në vitin 2012, me shumë 6.000 euro dhe shpenzime zhdoganimi.

Subjekti ka shpjeguar⁸⁵ se si burim për blerjen e automjetit nga kunati ka qenë kryesisht e ardhura e siguruar nga biznesi familjar, me veprimtari “bar-kafe-restorant” si dhe ambient sportiv “F”, i cili ndodhet në Dibër, M, lagjja “Q”, rruga “M”.

Në vijim, në përgjigje të pyetësorit, datë 21.12.2021, subjekti ka saktësuar⁸⁶ se burimi i të ardhurave të kunatit për blerjen e këtij automjeti janë të ardhurat e siguruar nga biznesi i tyre familjar, i regjistruar më 14.2.2002 (datë kur ka filluar funksionimi i regjistrimeve *online*, por që si biznes është krijuar dhe ka funksionuar rregullisht që në vitin 1996), në emër të vëllait të tij L.N.

Subjekti ka depozituar⁸⁷ certifikatën personale të shtetasit B.N, të gjeneruar elektronikisht nga Zyra e Gjendjes Civile Peshkopi në datën 15.5.2020, si dhe certifikatën e trungut familjar të vitit 1974 të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Peshkopi në datën 17.1.2019, ku provohet lidhja familjare e subjektit me pronarin e automjetit B.N dhe shtetasin L.N.

⁷⁸Mjeti me targa DI *** A, në pronësi të z. B.N dhe përdorues z. B.N për vitet 2011 – 2019; mjeti me targa AA *** JF, me përdorues z. B.N në periudhën 20.7.2015 – 28.7.2017; mjeti me targa TR *** I, me përdorues B.N në periudhën 14.10.2008 – 29.10.2010.

⁷⁹Me shkresën nr. *** prot., datë 24.11.2021.

⁸⁰Përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 24.11.2021.

⁸¹https://makina.al/automjete/mercedes-benz-e-*/

⁸²Përmes pyetësorit me *e-mail* datë 8.5.2020.

⁸³Shpjegimet e subjektit datë 28.5.2020 në përgjigje të pyetësorit datë 8.5.2020.

⁸⁴Përmes pyetësorit datë 8.5.2020.

⁸⁵Shpjegimet e subjektit datë 28.5.2020, në përgjigje të pyetësorit datë 8.5.2020.

⁸⁶Shpjegimet me *e-mail*, datë 28.12.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 21.12.2021.

⁸⁷Depozituar nga subjekti me *e-mail* datë 28.12.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 21.12.2021.

Për dokumentimin e të ardhurave të realizuara nga aktiviteti tregtar në emër të shtetasit L.N me NIPT K***S, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar⁸⁸ se i është drejtuar me kërkesë për informacion, datë 23.12.2021, Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Dibër dhe Bashkisë Dibër, por nuk i është kthyer një përgjigje në lidhje me informacionin e kërkuar.

Për të provuar këtë fakt, subjekti ka depozituar⁸⁹ kopje të lajmërim marrjes të postës shqiptare dhe kopje të kërkesës së tij, të protokolluar nga Drejtoria e Tatimeve Dibër në datën 28.12.2021.

Lidhur me të ardhurat e biznesit familjar, subjekti ka depozituar dokumentacion provues⁹⁰, si vijon:

- ekstrakt historik i lëshuar nga QKB-ja në datën 12.5.2020, për subjektin tregtar “L.N”, person fizik, i regjistruar në datën 14.2.2002, me objekt veprimtarie “bar-kafe-restorant”, me adresë në M, D, me status aktiv;
- certifikatë regjistrimi i personit të tatueshëm “L.N”, person fizik, me NIPT K***S, datë regjistrimi 14.2.2002, me adresë në M, D;
- kontratë e energjisë elektrike e lidhur në datën 1.3.2007 në emër të z. B.N (babai i shtetasve B dhe L.N), për klientin e kategorisë jo familjare;
- autorizim administrativ (person fizik) me nr. **, për vitin 2005, nga Inspektorati Shtetëror i Punës, dega Dibër, në emër të z. L.N;
- libri i shitjeve (qarkullimit) i fragmentuar nr. ***, për vitin 2010 dhe një faqe e këtij libri;
- vendim nr. ***, datë 29.10.2010, i Inspektoratit Sanitar Shtetëror Dibër, në emër të z. L.N, për kryerjen e inspektimit higjieno - sanitar të aktivitetit të biznesit të këtij shtetasi;
- libri i xhiros, me kod ***, për vitin 2003 dhe faqet e këtij libri për periudhën janar – dhjetor 2003;
- vërtetim nr. ** prot., datë 14.2.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, e cila konfirmon se nga verifikimi i volumit të vendimeve, i krijuar nga gjykata për përdorim të brendshëm (pasi për efekt të ligjit “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” librat e personave fizikë bashkë me praktikën mbaheshin në Gjykatën e Rrethit Dibër për periudhën 1991 – 2007), në faqen ** të këtij volumi, figuron e dhëna: *vendim me nr. **, datë 5.2.1998, në emër të shtetas D. N, me aktivitet “tregti”*.
- vërtetim nr. ** prot., datë 14.2.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, e cila konfirmon se nga verifikimi i volumit të vendimeve i krijuar nga gjykata për përdorim të brendshëm, në faqen ** figuron e dhëna: *vendim nr. **, datë 14.2.2002, në emër të shtetasit L.N, me aktivitet “tregti”*;
- deklaratë noteriale nr. ***, datë 14.2.2022, e shtetasit L.N, i cili konfirmon regjistrimin e këtij biznesi;
- fotografi të biznesit;
- deklaratë noteriale datë 31.3.2022, e shtetasit B.N(pronari faktik i automjetit), i cili deklaroi se automjetin ia ka lënë në përdorim motrës së tij R.M në Tiranë, pasi kishte një automjet tjetër në përdorim dhe duke qene se këtë automjet ka dashur ta shesë, ky shtetas ka publikuar njoftimin për shitje, duke vendosur numrin e kontaktit të z. Hysni Mulaj për lehtësi të shitjes së automjetit, meqenëse ai jeton në Tiranë;
- kërkesë për informacion e protokolluar nga Drejtoria Tatimore Dibër në datën 28.12.2021 dhe kopje të njoftimit postar për marrjes së kërkesës nga kjo drejtori;

⁸⁸Shpjegimet e subjektit me e-mail datë 28.12.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 21.12.2021 dhe shpjegimet me e-mail datë 31.3.2022.

⁸⁹Kërkesë për informacion drejtuar Drejtorisë së Tatimeve Dibër, e protokolluar nga kjo e fundit në datën 28.12.2021 dhe kopje të lajmërimit postar për marrjen e kërkesës nga Drejtoria Tatimore Dibër në datën 28.12.2021.

⁹⁰Dokumentacion i dërguar nga subjekti me e-mail datë 28.12.2021 dhe e-mail 14.1.2022 (në përgjigje të pyetësorit datë 21.12.2021), me e-mail datë 18.2.2022 (në përgjigje të pyetësorit datë 11.2.2022), si dhe dokumentacion shtesë i dërguar me e-mail datë 31.3.2022.

- vërtetim i Bashkisë Dibër në datën 31.3.2022, për likuidimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore nga z. L.N për vitin 2021;
- vërtetim datë 31.3.2022, i gjeneruar elektronikisht nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, e cila ka dërguar të dhëna mbi xhiron e 3 viteve të fundit (2019 - 2021) nga personi fizik “L.N”;
- vërtetim datë 31.3.2022, gjeneruar elektronikisht nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, e cila ka dërguar të dhëna mbi kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të derdhura të deklaruara nga z. L.N për periudhën prill 2019 – janar 2022.

Gjatë hetimit shtesë, subjekti ka shpjeguar⁹¹ se ka mundur të sigurojë dokumentacion⁹² provues, konkretisht të viteve 2006, 2007, 2009, 2010, 2011 deri në vitin 2012, i cili disponohej rastësisht nga kunati, në lidhje me aktivitetin e biznesit të familjes.

Gjithashtu, subjekti ka depozituar dokumentacion⁹³ të lëshuar nga ISSH-ja Dibër, ku konfirmohet se në emër të nënës së bashkëshortes D.N janë derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore si biznes i vogël për periudhën 1998 – 2001.

Sipas shpjegimeve të subjektit⁹⁴, ky dokumentacion shtesë, si dhe ato të depozituara më herët pranë Komisionit, tregojnë qartazi se biznesi familjar i kunatit ka gjeneruar të ardhura të konsiderueshme, si burim i ligjshëm, për blerjen e automjetit nga kunati dhe për krijimin e depozitës nga bashkëshortja para martesës dhe të depozitave të familjarëve të bashkëshortes.

Gjatë hetimit shtesë, Komisioni ka kërkuar informacion pranë organeve përkatëse tatimore lidhur me të ardhurat e gjeneruara nga biznesi familjar i kunatit, ku nga të dhënat e Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër⁹⁵ rezultoi se personi fizik “D.N” (nëna e bashkëshortes) nuk është e regjistruar si tatimpaguese pranë DRT-së Dibër, ndërsa nga Bashkia Dibër⁹⁶ nuk rezultoi asnjë dokument në lidhje me biznesin e vogël të shtetases D.N.

Sa i përket aktivitetit të biznesit në emër të shtetasit L.N (vëllai i bashkëshortes), nga informacioni i ardhur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër⁹⁷ ka rezultuar se tatimpaguesi L.N me NIPT K***S është i regjistruar pranë DRT-së Dibër si person fizik me aktivitet “bar-kafe-restorant” në datën 14.2.2002 dhe vazhdon të jetë me status aktiv, por për shkak të mangësisë të trashëguara në ruajtjen, administrimin, inventarizimin dhe arshivimin e dokumentacionit tatimor është në pamundësi objektive për dërgimin e informacionit për periudhën 2002 – 2009.

⁹¹Shpjegimet e subjektit depozituar në Komision me nr. *** prot., datë 26.4.2022.

⁹²Dokumentacion shtesë i depozituar nga subjekti (me CD) protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 26.4.2022: formular i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për periudha të ndryshme tatimore (3-mujori i II vitit 2006; 3-mujori i 4 vitit 2006; 3-mujor 2007; 3-mujori i II vitit 2007; 3-mujori i I vitit 2009; 3-mujori i II vitit 2009, qershor 2011; shtator 2011); listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi (biznes i vogël) për periudhën tatimore 3-mujori IV, viti 2010; 3-mujori IV viti 2011; 3-mujori 1.1.2011-31.3.2011; 3-mujori 1.4.2011 - 30.6.2011; 3-mujori III-të viti 2012; 3-mujori I-rë viti 2012; 3-mujori II viti 2012; formular i deklarimit dhe pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për periudhën tatimore 2006; formular i deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për periudhën tatimore (3-mujori tetor 2006; 3-mujori tetor 2006; 3-mujori i I, viti 2007; 3-mujori i II, viti 2007; mars 2011; dhjetor 2010; dhjetor 2011); formular i urdhër pagesës për deklarimin elektronik të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për periudhën tatimore (dhjetor 2010, mars 2012); mandate të ndryshme bankare të pagesave të kryera në BKT, “Raiffeisen Bank” dhe “Societe Generale Albania Bank”.

⁹³Dokumentacion shtesë i depozituar nga subjekti (me CD) protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 26.4.2022: vërtetim nr. *** prot, datë 2.2.2006, i lëshuar nga ISSH-ja, e cila konfirmon periudhën e punësimit të znj. D.N pranë NBSH Peshkopi, për periudhën 1974 – 1993; vërtetim nr. *** prot., datë 12.12.2011, e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Dibër, e cila konfirmon se znj. D.N, si biznes i vogël është siguruar për periudhën 1.1.1998 – 30.6.2001; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare, e lëshuar nga ISSH-ja, ku konfirmohen kontributet e derdhura për znj. D.N si biznes i vogël, në Peshkopi, Maqellarë, për vitet 1998, 1999, 2000 dhe 2001; vërtetim “Për të vetëpunësuarin në bujqësi” i lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Dibër, në datën 1.8.2012, e cila konfirmon se znj. D.N figuron si e vetëpunësuar në bujqësi që nga viti 2004, për të cilën janë derdhur kontributet në periudhën e viteve 2004 – 2008.

⁹⁴Shpjegimet e subjektit të depozituara në Komision me nr. *** prot., datë 26.4.2022.

⁹⁵Me shkresën nr. *** prot., datë 6.5.2022.

⁹⁶Me shkresën nr. *** prot., datë 14.4.2022.

⁹⁷Me shkresën nr. *** prot., datë 4.5.2022 dhe shkresën nr. *** prot., datë 5.5.2022.

Nga të dhënat e sistemit C@ts rezulton të ketë paguar kontributet shoqërore për periudhën mars 2010 – dhjetor 2012 dhe tatim mbi të ardhurat nga punësimi për periudhën korrik 2010 – dhjetor 2012.

Ndërsa, Bashkia Dibër⁹⁸ ka informuar se për subjektin tatimpagues “L.N” nuk rezulton asnjë dokument në lidhje me biznesin e vogël për periudhën 2002 – 2012, pasi dokumentacioni i ish-Komunës Dibër është dorëzuar në Arkivin Shtetëror Vendor Dibër.

Komisioni ka kërkuar informacion pranë Arkivit Shtetëror Vendor, e cila ka dërguar⁹⁹ të dhënat që dispononte lidhur me aktivitetin e biznesit “bar-bufe” të ndodhur në Komunën Maqellarë, Dibër, në emër të shtetases D.N për vitet 2003 - 2004 dhe në emër të shtetasit L.N për vitin 2009, si dhe të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve e rrethit Dibër, për vitin 2003 dhe për vitin 2006.

Ndërsa, për vitin 2002, vitet 2005 - 2008 dhe 2010 - 2012 nga kërkimet e kryera në dokumentet që disponojnë (Komuna Maqellarë) në Arkivin Shtetëror Vendor Dibër nuk u gjenden të dhëna. Bashkëlidhur shkresës ndodhet dokumentacioni¹⁰⁰ që disponohej nga kërkimi në arkivë.

3.2.2 Komisioni i ka kërkuar¹⁰¹ subjektit të depozitohet dokumentacion mbi çdo investim të kryer nga shtetasi B.N, në pasuri të luajtshme dhe paluajtshme, deri në momentin e blerjes së automjetit (në vitin 2012), për të cilën subjekti ka shpjeguar¹⁰² se nuk ka kryer investim në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme deri në vitin 2012.

3.3 Konstatime të Komisionit:

- nuk u provuan të ardhurat e ligjshme të pronarit (kumatit) për blerjen e automjetit me shumën (6.000 euro dhe zhdoganimin), e konvertuar në vlerën 1.009.539 lekë;
- nga analiza e kryer, nëse subjekti do ta kishte blerë vetë automjetin në vitin 2012, do të rezultonte me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme në shumën 948.667 lekë;
- subjekti e ka përdorur këtë automjet që nga momenti i blerjes dhe në vijimësi.

Komisioni, lidhur në konstatimet e mësipërme, i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

3.4 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

⁹⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 14.4.2022.

⁹⁹Me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2022.

¹⁰⁰Shkresë nr. *** prot., datë 27.3.2003, e Komunës Maqellarë, drejtuar Degës së Tatimeve Dibër së bashku me listën emërore të subjekteve private që zhvillojnë aktivitet në Komunën Maqellarë për vitin 2003, ku evidentohet emri i D.N e cila nuk ka derdhur taksat për vitin 2003; shkresë nr. ** prot., datë 28.1.2004, e Komunës Maqellarë, drejtuar Degës së Tatim-Taksave Dibër, së bashku me listën e subjekteve të regjistruar për vitin 2003, ku në numri rendor * evidentohet emri i D.N; shkresë nr. *** prot., datë 2.12.2009, e Komunës Maqellarë “Informacion mbi xhiron vjetore të biznesit të vogël për vitin 2009”, së bashku me listën e subjekteve të biznesit të vogël, ku në numrin rendor ** evidentohet aktiviteti i biznesit “bar-bufe” në emër të z. L.N me NIPT K***A, me xhiro në shumën 1.750.000 lekë; shkresë nr. *** prot., datë 29.8.2003, e Degës së Tatim-Taksave Dibër, e shoqëruar me Regjistrin e Tatimpaguesve Tatim Vendor mbi Biznesin e Vogël/Tatim-Fitimi i Thjeshtuar, Komuna Maqellarë, ku evidentohet aktiviteti i biznesit në emër të z. L.N; procesverbal i mbajtur në datën 12.4.2006 nga përfaqësuesit e autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi kontrollin e ushtruar për aktivitetin e vitit 2005, ku ka rezultuar se për 20 subjekte tregtare, midis të cilëve edhe aktiviteti i z. L.N, rezultuan me diferencë të ardhurash për vitin 2004 - 2005 dhe në momentin e vendosjes së detyrimit të vitit ushtrimor nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat e vitit të mëparshëm, duke shkaktuar një dëm ekonomik në buxhetin e shtetit për shumën 746.707 lekë. Në dosjet e këtyre subjekteve mungonin procesverbalet e kontrollit për verifikimin e xhiros dhe disa dokumente bazë për llogaritjen e detyrimeve si: deklarata për të ardhurat e realizuara për vitin që mbyllet nga vetë subjekti, libri i xhiros, blerjes së subjektit, fatura model për shitjet e bëra ose të shpërndara, formulari i regjistrimit për subjektet e reja; observacion në lidhje me procesverbalin e datës 12.4.2006.

¹⁰¹Përmes pyetësorit datë 21.12.2021.

¹⁰²Shpjegimet e subjektit me e-mail datë 28.12.2021, në përgjigje të pyetësorit datë 21.12.2021.

Lidhur me të ardhurat e ligjshme të pronarit të automjetit, me prapësimet e datës 8.3.2022 subjekti ka depozituar dokumentacion shtesë, si vijon:

- *statement* të llogarisë lëshuar nga BKT-ja në datën 7.3.2022, në emër të kunatit B.N, të hapur në datën 1.1.2009;
- *statement* bankar të llogarisë rrjedhëse dhe depozitës, në emër të shtetasit B.N(vjehri) lëshuar nga BKT-ja në datën 7.3.2022, të çelur në vitin 2005, ku konfirmohet hapja e depozitave të kursimit;
- librezë kursimi nr. *** në emër të shtetasit B.N (vjehri i subjektit) pranë Bankës së Kursimeve, lëshuar në datën 19.6.1998 nga Banka e Kursimeve Peshkopi, të njehsuar me origjinalin;
- librezë depozite nr. ***, në emër të shtetasve L ose B.N, e hapur në datën 7.2.2007;
- kontratë depozite bankare datë 2.11.2011, midis shtetasve L.N ose B.N dhe BKT-së, bashkë me kërkesë për transaksion të lëshuar dhe vulosur nga kjo bankë.

Në prapësimet e datave 8.3.2022 dhe 26.5.2022, subjekti ka shpjeguar se familja e kunatit ka gjeneruar, ndër vite, të ardhura familjare, të cilat kanë pasur si burim të ardhurat nga pagat e pjesëtareve të familjes, si të ardhurat nga biznesi i tyre familjar, ku një pjesë e tyre janë depozituar në formë kursimesh në BKT, në periudha të ndryshme, në emër të babait B.N dhe z. B. N, para se të blihej automjeti. Sipas subjektit, këto të ardhura të depozituara në formë kursimesh tregojnë tej çdo dyshimi mundësinë financiare për blerjen e automjetit nga kunati i tij.

Lidhur me publikimin në website të numrit të subjektit për shitjen e automjetit, në seancën dëgjimore të datës 25.3.2022, subjekti ka shpjeguar se meqenëse automjeti shumicën e kohës rrinte në Tiranë, kunati ka kryer aplikimin për shitje, duke vendosur numrin e kontaktit të subjektit. Subjekti ka saktësuar se përdorimin e këtij automjeti e ka deklaruar dhe e ka përdorur së bashku me bashkëshorten, por ky automjet është në pronësi të kunatit të tij dhe, për rrjedhojë, kërkoj nga Komisioni që blerja e automjetit mos t'i llogaritet në analizë financiare. Subjekti pretendon se është e padrejtë që të konsiderohet se ky automjet është blerë nga të ardhurat e tij, duke i lënë barrën e provës sipas analizës financiare.

3.5 Vlerësimi i Komisionit

Komisioni, në analizë të provave të administruara gjatë hetimit, si dhe shpjegimeve të subjektit pas kalimit të barrës së provës, ka hetuar në disa drejtime për të verifikuar faktet e paraqitura gjatë hetimit, së pari në drejtim të verifikimit të mundësisë së shtetasit B. N. (pronari i automjetit) për të blerë automjetin objekti hetimi, me të ardhura nga burime të ligjshme, dhe së dyti, në drejtim të verifikimit të deklaratimit të subjektit të rivlerësimit, ku ka konstatuar se:

- i) subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* automjetin në përdorim, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 84/2016;
- ii) nga policat e sigurimit, subjekti dhe bashkëshortja rezultojnë përdorues të automjetit, ndërsa pronar i saj është shtetasi B.N;
- iii) nga të dhënat e sistemit *TIMS* ka rezultuar se pronari i automjetit ka përdorur vetëm një herë këtë mjet jashtë territorit të Shqipërisë, në datën 15.3.2014;
- iv) automjeti është përdorur nga subjekti dhe bashkëshortja jashtë Shqipërisë, vetëm në një pikë kufitare (Qafë-Morinë), në drejtim të qytetit të Tropojës, e kryer tranzit përmes Kosovës dhe nuk është përdorur për destinacione të tjera jashtë vendit;
- v) subjekti ka provuar me dokumentacion aktivitetin e biznesit të familjes së bashkëshortes, i filluar që nga viti 1998 dhe regjistruar në vitin 2002, i cili vazhdon dhe aktualisht me status aktiv, por dokumentacioni i paplotë i disponuar nga institucionet përkatëse, e vendos në

vështirësi Komisionin për të përlogaritur të ardhurat reale të gjeneruara ndër vite nga ky aktivitet;

vi) nga të dhënat bankare të shtetasit B.N (vjehtëri i subjektit) ka rezultuar se ka pasur depozita në Bankën e Kursimeve dhe në BKT në periudhën 1998 – 2019, ku në vitin 2012, kur është blerë automjeti, familja e bashkëshortes ka pasur kursime të konsiderueshme në bankë. Po ashtu, nga të dhënat bankare në emër të shtetasit B.N, ka rezultuar se janë hapur depozita në BKT në vitin 2013, të cilat janë shtuar me kalimin e viteve deri në vitin 2019.

Komisioni, në këndvështrim të kësaj situatë faktike, çmon të rëndësishme të veçojë disa rrethana që e përcaktojnë qëndrimin e saj në lidhje me këtë pasuri, duke vlerësuar se deklaratimet e subjektit lidhur me pronësinë dhe me përdorimin e këtij automjeti duken bindëse:

Së pari, marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me këtë automjet, send të luajtshëm në kuptim të parashikimeve të Kodit Civil dhe të ligjit nr. 84/2016, është një marrëdhënie juridiko-civile e huapërdorjes, e rregulluar shprehimisht nëpërmjet autorizimit noterial nr. ***rep., datë 10.8.2012, përmes së cilës subjekti është autorizuar që të qarkullojë me këtë mjet brenda dhe jashtë vendit, akt i paraqitur me cilësinë e provës në hetim prej vetë subjektit të rivlerësimit.

Në analizë të këtij veprimi juridik, rezulton se subjekti ka fituar të drejta përdorimi mbi këtë automjet, sipas parashikimeve të nenit 901 të Kodit Civil. Kjo e drejtë është gëzuar realisht prej subjektit, sipas pohimeve të tij, edhe për shkak të marrëdhënies së posaçme familjare të subjektit me familjen e bashkëshortes, çka krijon bindjen e Komisionit se dyshimet nuk janë në nivel të tillë për të arritur në konkluzionin e fshehjes së pasurisë, por justifikojnë përdorimin e mjetit nga subjekti dhe bashkëshortja.

Së dyti, në lidhje me verifikimin e mundësisë së kunatit B.N, për blerjen e automjetit në vitin 2012 me burime të ligjshme, nga hetimi i kryer nuk u provua tërësisht mundësia financiare e kunatit për blerjen e automjetit, për shkak të të dhënave të pamjaftueshme të dërguara nga organet përkatëse tatimore. Nga ana tjetër, problematikat institucionale nuk mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit.

Së treti, shtojca nr. 2 e ligjit nr. 84/2016 ngarkon subjektet e rivlerësimit me detyrimin për të deklaruar të drejtat e përdorimit mbi sende të paluajtshme e të luajtshme, detyrim të cilin subjekti i rivlerësimit e ka përmbushur, duke e deklaruar këtë automjet në përdorim, në deklaratën e pasurisë *Vetting*.

Nisur nga sa më sipër, si dhe referuar faktit që në rastin konkret subjekti nuk ndodhet në kushtet e një huamarrjeje të një vlere monetare, por në kushtet e huapërdorjes së një objekti për të cilin nuk u vërtetua që të jetë në pronësi të fshehur të tij, Komisioni vlerësoi se mungesa e të dhënave të huadhënësit për të blerë automjetin nuk mund ta penalizojë subjektin e rivlerësimit, në kuptim të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

4. Të ardhura¹⁰³ në vlerën 2.115.046 lekë, nga paga e bashkëshortes, depozituar në “Credins Bank”, në emër të bashkëshortes R.N

4.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

“Credins Bank”¹⁰⁴ ka dërguar të dhëna lidhur me depozitën bankare në emër të bashkëshortes së subjektit R.M(N), në shumën 2.001.564 lekë. Referuar pasqyrave të llogarive të dërguara nga banka, evidentohen depozitat bankare si vijojnë:

- depozitë (3-mujore) në shumën 200.000 lekë, çelur në vitin 2007 dhe mbyllur në vitin 2008;

¹⁰³Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: nxjerrje llogarie datë 20.10.2016 në “Credins Bank”. Gjendja e depozitës në emër të znj. R.N, në shumën 2.098.023 lekë.

¹⁰⁴Shkresë nr. *** prot., datë 6.11.2020.

- depozitë (6-mujore), çelur në vitin 2008 me shumë 361.466 lekë dhe mbyllur në vitin 2013;
- depozitë (6-mujore), çelur në vitin 2013 me shumë 1.859.245 lekë dhe mbyllur në vitin 2014.
- depozitë (12-mujore), çelur në vitin 2014 me shumë 2.001.564 lekë.

Nga verifikimi i deklaramëve¹⁰⁵ periodike, subjekti dhe bashkëshortja i kanë deklaruar këto shuma të depozituara në bankë në vitet përkatëse dhe se këto deklarime përputhen me dokumentacionin e administruar në dosje.

4.2 Analizë financiare

Komisioni kreu analizën financiare për të vlerësuar mundësinë e bashkëshortes së subjektit për krijimin e kësaj depozite bankare në vite për periudhën 2008 – 2016, duke marrë në konsideratë:

- të ardhurat e subjektit bazuar në vërtetimet e pagave në vite;
- të ardhurat e bashkëshortes bazuar në vërtetimet e pagave në vite;
- të ardhurat nga interesat e depozitave në vite, bazuar në *statement*-et bankare;
- pagesat e kryera për shlyerjen e huas ndaj babait janë bazuar dhe përlllogaritur në deklaramet periodike të subjektit;
- shpenzimet e jetesës për periudhën 2008 – 2016 janë bazuar në deklaramet e subjektit të rivlerësimit. Duke qenë se këto shpenzime janë disafish më të larta se standardi i ILDKPKI-së¹⁰⁶, nuk janë përfshirë si zë më vete shpenzime për udhëtime dhe shkollimi në analizën financiare për periudhën 2009 – 2016. Shumat e deklaruara të subjektit janë të tilla që i mbulojnë edhe këto shpenzime të përlllogaritura nga Komisioni;
- për analizimin e kursimeve *cash* të subjektit të rivlerësimit u morën në konsideratë deklaramet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat vjetore të interesave pasurore, si dhe gjendja në fund të vitit të likuiditeteve në bankë të subjektit dhe bashkëshortes.

Komisioni kreu analizën financiare mbi mundësinë e bashkëshortes së subjektit për krijimin e depozitës bankare në vite dhe përballuar shpenzimet e tjera për periudhën 2008 – 2016, nga ku rezultoi një balancë negative në shumën 76.531 lekë në vitin 2014, për të përballuar shpenzimet dhe rritur likuiditetet në bankë. Komisioni, në lidhje me këtë balancë negative, i ka ngarkuar subjektin barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

4.3 Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit

Në prapësimet e datës 26.5.2022, subjekti ka shpjeguar se balanca negative prej 76.531 lekësh i përket vetëm vitit 2014 dhe nuk ka logjikë ekonomike për të arritur në konkluzionin se subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë pasur mundësi financiare për krijimin e depozitës bankare sepse kjo llogari bankare është kredituar nga pagat e tyre, të cilat janë burime të ligjshme.

4.4 Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues vlerëson se balanca negative e rezultuar nga analiza financiare është relativisht e vogël, në raport me të ardhurat e përfituara dhe shpenzimet e kryera, nisur edhe nga fakti se subjekti ka deklaruar shpenzime jetese shumë të larta krahasuar me standardin e ILDKPKI-së dhe INSTAT-it. Vetë natyra e analizës financiare është e përafërt dhe jo absolute, e cila mund të paraqesë një shkallë të caktuar pasaktësie në elementët që vlerëson dhe shërben si një tregues i të ardhurave të ligjshme, pasurive dhe shpenzimeve të jetesës për një periudhë kohe. Duke

¹⁰⁵Në DPV-në e vitit 2007: “Depozitë bankare 200.000 lekë të çelur pranë ‘Credins Bank’ në vitin 2007”. Në DPV-në e vitit 2009: “Të ardhura nga paga në bankën e kursimeve ‘Credins’, në emër të bashkëshortes me shumë 398.275 lekë”. Në DPV-në e vitit 2013: “Nga të ardhurat e pagës një pjesë janë depozituar në depozitë në ‘Credins Bank’ në emër të bashkëshortes me shumë 300.000 lekë.

¹⁰⁶Bazuar në shkresën me nr. ***, datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së, shpenzimet për periudhën 2007 – 2016 do të ishin në shumën 5.889.052 lekë, ndërsa subjekti ka deklaruar për të njëjtën periudhë shumën 10.311.372 lekë.

genë një balancë relativisht e vogël, si e tillë, nuk arrin nivelin e cenimit të besimit të publikut dhe as nuk ngre dyshime mbi mundësitë financiare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se mungesa e këtij likuiditeti (në masën 76.531 lekë), nuk ndikon në vlerësimin tërësor të çështjes për të penalizuar subjektin në vendimmarrjen ndaj tij.

DETYRIMET FINANCIARE NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË

5. Hua në shumën 4.000.000 lekë, marrë nga babai për blerjen e apartamentit në vitin 2004. Shuma e detyrimit financiar e mbetur e pashlyer deri në datën e fillimit të rivlerësimit është 1.780.000 lekë.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës deklaraten noteriale nr. ***, datë 1.12.2011, e lëshuar nga z. R.M, përmes së cilës deklaroi se i ka dhënë djalit të tij, Hysni Mulaj, shumën 4.000.000 lekë në janar të vitit 2004, me kushtin që kur të përmirësohet gjendja financiare e tij t'i kthejë.

5.1 Komisioni analizoi mundësitë e subjektit për kthimin e huas, për periudhën 2006 – 2012

Nisur nga fakti se nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezultoi se babai i subjektit ka pasur mundësi për dhënien e huas në vitin 2004, si dhe fakti se subjekti ka deklaruar¹⁰⁷ në deklaratimet periodike vjetore shumat e shlyera çdo vit dhe detyrimin e mbetur të pashlyer të huas deri në dhjetor të vitit 2016, Komisioni kreu analizën financiare për mundësinë financiare të subjektit për kthimin e huas, sipas deklarimeve të tij në DPV-të për periudhën 2006 – 2012.

Në analizën financiare u përllogaritën:

- të ardhurat e provuara me dokumentacion të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes në vite;
- të ardhurat nga interesat e depozitave sipas vërtetimeve bankare;
- shpenzimet e jetesës janë përllogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së deri në vitin 2007, dhe për periudhën më pas janë reflektuar në analizë sipas deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike vjetore (DPV);
- kështu e shlyerjes së huas sipas deklarimeve të subjektit në DPV;
- shpenzimet e mobilimit u përllogaritën të shtrira në vitet 2006, 2007 dhe 2008 bazuar në deklaratimet e subjektit në pyetësorin standard, si dhe përgjigjeve të pyetësorëve gjatë hetimit;
- në lidhje me shumën *cash*, gjendjet e çdo fundviti janë bazuar në deklaratimet e subjektit në DPV-të vjetore;
- në lidhje me gjendjen *cash*, të deklaruar nga bashkëshortja në vitin 2007, gjatë hetimit shtesë nuk u provua burimi dhe, për rrjedhojë, kjo e ardhur *cash* nuk u reflektua në analizë.

5.2 Konstatime të Komisionit

Nga analiza e kryer nga Komisioni lidhur me kthimin e huas, rezultoi një balancë negative për të përballuar shpenzimet, për krijim likuiditetesh dhe pagesat për kthim të huas i shtrirë në vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2010, në shumën totale 1.593.250 lekë.

Në lidhje me këtë balancë negative të shtrirë në vite, subjektit iu kalua barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 5, të Nenit D, të Kushtetutës.

5.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

¹⁰⁷Në DPV-të për periudhën 2006 – 2016, te rubrika “detyrime financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë”.

Subjekti, përmes prapësimeve të datës 26.5.2022, argumentoi se në analizën financiare të kryer nga Komisioni për këtë periudhë duhet të merren në konsideratë: (i) fakti se për vitin 2007 është shtuar gabimisht gjendja *cash*, ku sipas DPV-së së vitit 2007 është deklaruar vetëm shuma prej 555.217 lekësh, që dispononte bashkëshortja; (ii) në përgjigje të pyetësorit datë 21.12.2021 subjekti ka saktësuar shtesat dhe pakësimet çdo vit, ku për vitin 2010 ka deklaruar “pakësim të gjendjes *cash* në shumën 505.000 lekë. Gjendja *cash* në fund të vitit 2010 ka qenë në vlerën 300.000 lekë”; (iii) kësti në vlerën 120.000 lekë është shlyer ndaj babait në vitin 2011, duke saktësuar se në DPV-në e vitit 2012 ka deklaruar shumën totale të shlyer deri në deklaratat e mëparshme; (iv) në vitet 2010 dhe 2011 subjekti prapëson se duke deklaruar shpenzimet familjare ka konsideruar edhe kthimin e huas të dhënë babait, me pretendimin se Komisioni ia ka llogaritur dy herë shpenzimin për kthimin e huas, duke i vendosur edhe në zërin e shpenzimeve jetike dhe në zërin e kthimit të huas; (v) në fund të vitit 2005 ka deklaruar shumën 800.000 lekë, duke pasur në konsideratë të gjitha kursimet që kishte deri në fund të këtij viti (pa i ndarë sa kishte në shtëpi dhe sa kishte në bankë), nga të cilat një pjesë e tyre prej 221,650 lekësh i kishte kursime në bankë dhe diferencën prej 578,350 lekësh i ka pasur gjendje në shtëpi; (vi) shpenzimet jetike në vitin 2005 duhet të llogariten për një person, pasi në këtë periudhë subjekti ka jetuar vetëm në qytetin e Bulqizës; (vii) saktësim të shpenzimeve të mobilimit të apartamentit (si pretenduar më lart nga subjekti).

Subjekti ka paraqitur analizën financiare mbi mundësitë e kthimit të kësteve të huas babait për periudhën 2006 – 2012, duke pretenduar se rezulton me bilanc pozitiv për çdo vit, për shlyerjen e kësteve të huas, ndër vite, për përballimin e shpenzimeve dhe krijimin e likuiditeteve.

5.4 Vlerësimi i Komisionit

Komisioni, lidhur me deklarimin e gjendjes *cash* në deklaratimet periodike ndër vite, çmon se këto pretendime të subjektit për trajtimin ndryshe të mënyrës së deklarimit janë në mospërputhje me detyrimet e tij si subjekt deklarues. Pavarësisht nga ndryshimet që ka pësuar ligji nr. 9049/2003 dhe formulari në rubrikat përkatëse, ligji në mënyrë konsistente ka kërkuar që subjektet deklaruese të shprehen për ndryshimet e pasurisë (shtesa dhe pakësime) dhe detyrimet financiare nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit, që lidhen me zyrtarin, bashkëshortin/en dhe fëmijët madhorë.

Në kuptim të këtij detyrimi ligjor, në formularin e deklarimit të pasurisë së vitit 2010, subjekti ka deklaruar: *“Të ardhura të siguruara nga paga ime dhe e bashkëshortes janë gjithsej 1.538.142 lekë, nga kjo një pjesë është pakësuar për pagimin e një pjese të huas së marrë për blerjen e banesës sime dhe konkretisht 300.000 lekë, një pjesë e këtyre të ardhurave është pakësuar për shpenzime familjare të ndryshme dhe konkretisht 902.880 lekë, një pjesë e të ardhurave të siguruara nga familja jonë janë depozituar në formë kursimesh në ‘Credins Bank’ në emër të bashkëshortes 335.262 lekë”.*

Sa më sipër, pretendimi i subjektit se shpenzimet familjare të deklaruara prej tij në vitin 2010 përfshijnë edhe kthimin e huas, nuk qëndron pasi në DPV-së në vitin 2010, subjekti ka deklaruar kthimin pjesor të huas veçmas nga shpenzimet familjare, ndërsa në DPV-në e vitit 2011, te rubrika e detyrimeve financiare subjekti nuk ka deklaruar ndryshime nga viti paraardhës, sa i përket kthimit të huas, siç ka deklaruar në vitet e tjera.

Sa i përket pretendimit të subjektit se në vitin 2005 ka deklaruar shumën 800.000 lekë pa përcaktuar sa ka qenë gjendje *cash* në banesë dhe sa në bankë, ky pretendim i subjektit nuk qëndron pasi në DPV-në e vitit 2005 subjekti ka deklaruar specifikisht: *“Gjendje cash nga paga ime si prokuror rrethi për vitin 2005 në shumën 800.000 lekë”*, duke saktësuar se shuma prej 800.000 lekësh është gjendje *cash* dhe jo likuiditet në bankë.

Komisioni kreu analizën financiare pas prapësimeve dhe çmoi të konsiderojë pretendimet e subjektit në lidhje me shpenzimet jetike për vitin 2005 dhe shpenzimet e mobilimit, ndërsa nuk konsideroi pretendimet e tjera të tij lidhur me gjendjet *cash* të deklaruara në vite, duke i përlllogaritur ato sipas standardit të ndjekur nga Kolegji.

Sa i përket shumës *cash* të deklaruar nga bashkëshortja në vitin 2007, ky pretendim u reflektua në analizë, referuar fakteve të përmendura në vijim (në pikën 6.4 të këtij vendimi), si dhe faktit se krijimi i kursimeve nga bashkëshortja, i takojnë një periudhe përpara se subjekti të ishte martuar.

Në përfundim, nga analiza e kryer pas prapësimeve, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet dhe pagesat për kthim të huas në vitet 2007 dhe 2010, në shumën totale 748.950 lekë.

Trupi gjykues, nisur nga fakti se subjekti ka deklaruar çdo vit shpenzime jetese shumë më të larta se standardi i ILDKPKI-së dhe INSTAT-it, të cilat duket se kanë shkaktuar këto balanca, çmon se kjo balancë negative nuk mund të përbëjë shkak për aplikimin e masës disiplinore të subjektit për shkarkim nga detyra, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

6. Verifikime të tjera të rezultuara gjatë hetimit administrativ

6.1 Komisioni hetoi lidhur me kursimet *cash* të deklaruara në deklaratat periodike ndër vite

Referuar DPV-së së vitit 2007 (vit i lidhjes së martesës së subjektit), bashkëshortja e subjektit, ka deklaruar shumën 810.000 lekë kursime nga të cilat: shumën 555.000 lekë *cash*, shumën 200.000 lekë depozitë në “Credins Bank”, si dhe shumën 55.000 lekë në llogari bankare.

Si burim krijimi për këto kursime, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar kursimet personale para dhe pas martese, si dhe të ardhurat e gjeneruara nga puna në institucione shtetërore, “Albtelekom” dhe Zyra Rajonale e Punës Tiranë.

Nga verifikimi i llogarive bankare të bashkëshortes R.N (M), u evidentua se:

- në llogarinë rrjedhëse në “Credins Bank”, ka kalime të pagave mujore nga Zyra Rajonale e Punës Tiranë, duke filluar që nga data 1.9.2006;
- në llogarinë në “Intesa Sanpaolo Bank” ka tërheqje *cash* të shumës 555.217 lekë, në datën 15.8.2007 dhe e ka mbyllur llogarinë.

Në përgjigje të pyetësorit dërguar në datën 8.2.2022, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar¹⁰⁸ se: *“Në lidhje me transaksionin e tërheqjes së shumës prej 555.217 lekësh më 15.8.2007 që figuron në statement e bankës, këtë shumë bashkëshortja ime ma ka deklaruar lekë cash, e cila figuron e deklaruar dhe në deklarinimin e pasurisë nga ana ime në vitin 2008”*.

Nisur nga fakti se burimi për gjendjen *cash* deklaruar nga bashkëshortja e subjektit është depozita e krijuar në vitin 2003, në “Intesa Sanpaolo Bank”, në shumën 4.000.000 lekë, Komisioni i ka kërkuar¹⁰⁹ subjektit të depozitojë dokumentacion justifikues mbi burimet për krijimin e kësaj depozite nga bashkëshortja.

Subjekti ka shpjeguar¹¹⁰ se familja e bashkëshortes, ndër vite, ka akumuluar të ardhura dhe kursime familjare, që kanë pasur burim kryesor të ardhurat nga puna në administratë shtetërore të anëtareve të familjes dhe të bashkëshortes, si dhe të ardhurat e realizuara nga biznesi i tyre

¹⁰⁸Shpjegimet e subjektit me e-mail, datë 10.2.2022.

¹⁰⁹Përmes pyetësorit të datës 11.2.2022.

¹¹⁰Shpjegimet e subjektit me e-mail datë 18.2.2022, në përgjigje të pyetësorit datë 11.2.2022.

familjar “Bar-Restorant”, në fshatin Maqellarë, Dibër, i cili ka qenë burimi kryesor i kësaj depozite.

Në vijim, subjekti ka shpjeguar se: *“Të ardhurat dhe kursimet, ndër vite të familjes, një pjesë e tyre, janë depozituar në Bankën Amerikane të Shqipërisë (tani ‘Intesa Sanpaolo Bank’) në emër të bashkëshortes R.N, pasi kjo bankë ofronte interesa të favorshme mujore, të cilat i kanë shërbyer bashkëshortes për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve për arsimin e lartë me shkëputje nga puna, në Tirane. Kjo shumë e depozituar në emrin e bashkëshortes, është tërhequr më vonë nga kjo bankë për t’u përdorur për nevoja të ndryshme familjare të babait, ku një sasi lekësh nga shuma e depozituar para martesës rreth 500.000 lekë, me marrëveshje të pjesëtareve të tjerë të familjes dhe kryefamiljarit B.N, është dhënë në formë dhurate për ta përdorur për nevoja të bashkëshortes R.N”.*

Subjekti ka depozituar dokumentacion¹¹¹ provues, lidhur me të ardhurat nga punësimi i anëtareve të familjes dhe të bashkëshortes, ndër vite, ndërsa të dhënat e rezultuara gjatë hetimit, mbi të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti i biznesit familjar të bashkëshortes (bar-restorant, në Maqellarë, Dibër) gjenden të listuara në pikën 3.2.1 të këtij vendimi¹¹².

Gjatë hetimit shtesë, Komisioni ka kërkuar informacion pranë institucioneve përkatëse, si Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, Bashkia Dibër dhe Arkivi Shtetëror Vendor Dibër, lidhur me të ardhurat e gjeneruara nga ky biznes familjar, ku nga analizimi i dokumentacionit të ardhur nga këto institucione¹¹³, ka rezultuar se këto të dhëna janë të paplota për të vlerësuar të ardhurat e gjeneruara, ndër vite, nga ky biznes i familjes së bashkëshortes.

6.2 Analiza financiare

Komisioni kreu një analizë financiare, në lidhje me burimet e ligjshme që ka pasur familja e bashkëshortes (nga pagat dhe aktiviteti bar-kafe), për shumën e depozituar në vitin 2003 nga bashkëshortja në “Intesa Sanpaolo Bank”.

Referuar faktit se burimi për gjendjen *cash* të deklaruar nga znj. R.N është depozita e krijuara në vitin 2003, analiza financiare është kryer për periudhën 1993 – 2003, sipas dokumentacionit dhe sqarimeve të subjektit. Nga analiza e kryer nuk u provuan burimet e ligjshme për krijimin e depozitës në vitin 2003, në emër të bashkëshortes dhe, për rrjedhojë, nuk u provuan burimet e ligjshme të shumës *cash* të deklaruar nga bashkëshortja, në deklarinimin e parë në vitin 2007, me cilësinë e “personit të lidhur” të bashkëshortes.

¹¹¹Dokumentacion i dërguar nga subjekti me e-mail, datë 18.2.2022, në përgjigje të pyetësorit, datë 11.2.2022: librezë pune në emër të F.N (me nr. regjistri themeltare ***); vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare, mbi të ardhurat e F.N, në periudhën 18.11.1993 – 23.9.1998; librezë pune në emër të shtetasës R.B.N (me nr. regjistri themeltar ***); vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare, mbi të ardhurat e shtetasës R.N, nga Drejtoria Rajonale e AKPA-ja Dibër, në periudhën 21.10.2002 – 21.10.2003; vërtetim nr. *** prot., datë 17.2.2022, për bazën e vlerësuar, mbi të ardhurat e shtetasës R. N, nga shoqëria “A”, për periudhën tetor 2001 – tetor 2002; librezë pune në emër të shtetasit B.N (me nr. regjistri themeltar **); vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare mbi të ardhurat e shtetasit B.N, për periudhën 1.1.1994 – 15.12.1996; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare mbi të ardhurat e B.N, për periudhën 1.1.1998 – 31.12.2000; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare mbi të ardhurat e B.N, për periudhën 1.2.2001 – 1.3.2004; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare mbi të ardhurat e shtetasit B.N, për periudhën 1.10.1996 – 16.12.1996.

¹¹²Te rubrika e “Mundësive financiare të kunatit për blerjen e automjetit”, pasuri në përdorim nga subjekti.

¹¹³Shkresat nr. *** prot, datë 6.5.2022, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër; nr. *** prot., datë 14.4.2022, e Bashkisë Dibër; nr. *** prot., datë 4.5.2022 dhe nr. *** prot., datë 5.5.2022, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër; si dhe shkresa nr. *** prot., datë 12.5.2022, e Drejtorisë së Arkivave Vendore.

Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

6.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në prapësim të rezultateve të hetimit, lidhur me burimin e krijimit të gjendjes *cash* të deklaruar nga bashkëshortja në vitin 2007, përmes prapësimeve të datës 18.3.2022, subjekti ka kërkuar që krahas të ardhurave të bashkëshortes nga paga e saj, si burim krijimi i këtyre të ardhurave, të merret në konsiderate edhe fakti se në këtë vit është martuar dhe ka organizuar ceremoninë martesore, duke ftuar të afërm dhe miq të dy familjeve dhe siç është tradite të ftuarit në shenjë respekti dhe kontributi i dhurojnë çiftit një shumë simbolike parash, që sipas subjektit kanë mbuluar shpenzimet dhe është akumuluar gjendje *cash* në shumën 1.000.000 lekë.

Sa i përket burimeve të ligjshme për krijimin e depozitës në vitin 2003, në emër të bashkëshortes, subjekti i qëndron shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit, ku si burim kanë shërbyer të ardhurat dhe kursimet, ndër vite, të familjes së bashkëshortes nga punësimi në administratë dhe biznesi i tyre familjar, të cilat kanë siguruar të ardhura të konsiderueshme në vazhdimësi që nga viti 1998 dhe në vazhdim.

Subjekti pretendoi se një pjesë e këtyre të ardhurave janë depozituar si kursime në emër të babait të bashkëshortes (të ndjerit B.N), referuar dy librezave të kursimeve pranë BKT-së, të cilat sipas subjektit tregojnë se familja e bashkëshortes ka gjeneruar të ardhura dhe madje ka kursyer nga këto të ardhura. Subjekti ka shpjeguar se ndodhet në pamundësi për të paraqitur dokumentacion për pagesën e detyrimeve tatimore dhe taksave vendore dhe me gjithë kërkesën e tij dhe të familjarëve të bashkëshortes nuk është bërë e mundur të sigurohet, për shkak të papërgjegjshmërisë së institucioneve lokale, të cilat kanë pasur detyrimin për evidentimin e çdo biznesi në atë zone, vjeljen e detyrimeve tatimore, si dhe ruajtjen e dokumentacionit përkatës.

Në funksion të prapësimeve të dërguara në datën 18.3.2022, subjekti ka depozituar shkresën¹¹⁴ e datës 14.1.2022, të Bashkisë Dibër, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila konfirmon aktivitetin tregtar në emër të shtetasit L.N (kunati i subjektit) i regjistruar në QKB, në datën 14.2.2002, por nuk disponon dokumentacion mbi të ardhurat e realizuara dhe pagesat e kryera (taksa dhe tatime) për vitin 2002 – 2012, pasi pagesat dhe bilancet kryheshin pranë ish-Komunës Maqellarë, sot Njësia Administrative, e cila është përgjegjgur se nuk gjenden në arshivën e saj.

Pas hetimit administrativ shtesë, përmes prapësimeve të datë 26.5.2022, subjekti pretendon se nga Komisioni është shtuar gabimisht gjendja *cash* për vitin 2007, çka vërtetohet nga deklarimi në DPV-në e vitit 2007, në të cilën ka deklaruar gjendje *cash* vetëm shumën që dispononte bashkëshortja. Sipas shpjegimeve të subjektit, në këtë vit, me gjendjen *cash* të trashëguar nga viti 2006 dhe me dhuratat e hedhura në dasmë, janë mbuluar shpenzimet për mobilimin në shumën 600.000 lekë dhe shpenzimet e tjera (ku përfshihen shpenzimet jetike dhe ato për dasmën) në shumën 397.521 lekë. Në llogaritjen e shpenzimeve jetike për vitin 2007, subjekti kërkon të merret në konsideratë fakti se 5 muaj ka qenë një person, pasi është martuar më 30.5.2007 dhe në shtator familja është bërë me 3 anëtarë.

Sipas subjektit, Komisioni në analizën financiare për këtë vit ka marrë në konsiderate gjendjen *cash* të deklaruar nga bashkëshortja dhe nuk i ka konsideruar ato si të ardhura të shtuara për familjen.

¹¹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2022.

Sipas analizës financiare të paraqitur nga subjekti, lidhur me gjendjen *cash* të deklaruar në vitin 2007, pas martesës me bashkëshorten, subjekti ka pretenduar se ka pasur mundësi të përballojë shpenzimet e deklaruara dhe të kursejë, likuiditetet, duke rezultuar me balancë pozitive.

Subjekti ka argumentuar se në referim të ligjit nr. 84/2016, neni 32 i tij, nuk ka pasur dhe nuk ka ndonjë lidhje pasurore direkte (kontrata qiraje, huamarrje ose dhënie) dhe, për rrjedhojë, nuk ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë dhe burimin e krijimit të pasurive të familjareve të bashkëshortes, para martesës. Por pavarësisht kësaj, subjekti ka argumentuar se ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të siguruar dokumentacion që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurisë nga familjaret e bashkëshortes, duke iu drejtuar institucioneve përkatëse. Subjekti kërkoi nga Komisioni, që kjo mosparaqitje e dokumentacionit provues, për shkak të papërgjegjshmërisë së institucioneve, që kanë administruar informacion në vite, t'i konsiderohet në kushtet ligjore të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti pretendon se nuk mund t'i lihet barra e provës për të vërtetuar burimet e pasurisë dhe detyrimet ndaj shtetit apo të tretëve të familjes së bashkëshortes.

Sa i përket, mundësisë financiare të bashkëshortes për depozitim në bankë të shumës 4.000.000 lekë, nga kursimet e familjes së bashkëshortes me të ardhurat e realizuara nga punësimi i anëtarëve të familjes dhe aktiviteti bar-kafe (biznes familjar), subjekti ka paraqitur një analizë financiare, duke marrë në konsideratë: (i) të ardhurat nga biznesi familjar (aktiviteti bar-kafe) nga viti 1994, duke marrë si bazë një fitim rreth 30% të xhiros vjetore; (ii) të ardhurat e familjarëve bazuar në vërtetimet nga sigurimet shoqërore; (iii) shpenzimet, për periudhën 1993 – 1999, të përlllogaritura në masën 50% të të ardhurave; (iv) lidhur me shpenzimet jetike, për periudhën 2000 – 2003, subjekti pretendoi se Komisioni i ka përlllogaritur sipas ILDKPKI-së, për pesë persona, pa marrë në konsideratë faktin që kjo familje ka jetuar në fshatin Maqellarë, Dibër dhe niveli i shpenzimeve ka qenë shumë më i vogël se subjektet e tjera që jetojnë në zona urbane e qytete të mëdha.

Sipas subjektit, analiza financiare, e kryer nga eksperti financiar për familjen e bashkëshortes nga viti 1993, provon se kjo familje ka pasur burime të ligjshme për krijimin e depozitës në vitin 2003 në emër të bashkëshortes dhe, rrjedhimisht, provohet dhe shuma *cash* që bashkëshortja dispononte në vitin 2007.

6.4 Vlerësimi i Komisionit

Komisioni, referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, si dhe shpjegimeve të subjektit, ka analizuar kursimet *cash* të deklaruara nga bashkëshortja në DPV-në e vitit 2007, të cilat kanë si origjinë depozitën e çelur nga bashkëshortja pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, në vitin 2003, disa vite para martesës së znj. R.N me subjektin e rivlerësimit.

Trupi gjykues, në situatën objekt vlerësimi, i jep rëndësi fakteve objektive dhe ligjore që janë të lidhura me faktet se: (i) faktin se nga hetimi i kryer nuk rezultuan të dhëna që subjekti dhe bashkëshortja R.N të kishin bashkëjetuar para lidhjes së martesës ligjore në datën 30.5.2007; (ii) depozita bankare është çelur nga bashkëshortja e subjektit para martesës me subjektin; (iii) në kohën kur janë përfituar këto të ardhura (viti 2003) znj. R.N nuk e gëzonte statusin e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe aq më pak statusin e personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të ligjit nr. 84/2016; (iv) provohet me dokumentacion ekzistenca e biznesit familjar të bashkëshortes, aktivitet i cili ka filluar që nga viti 1998 e aktualisht me status “aktiv”, por dokumentacioni i paplotë, për shkak të mangësive në administrimin dhe ruajtjen e tyre nga institucionet përkatëse, e vendos Komisionin në vështirësi për të përlllogaritur të ardhurat reale të gjeneruara, ndër vite, nga ky aktivitet; (v) personat familjarë të bashkëshortes nuk kanë pasur asnjë detyrim për të mbajtur dhe ruajtur dokumentacion mbi të ardhurat e ligjshme që do të përdoreshin për investime në të ardhmen dhe nuk mund të trajtohen

si persona të tjerë të lidhur në kuptim të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, që rregullojnë këtë status; (vi) nga të dhënat bankare në emër të z. B.N (vjehtëri i subjektit) kanë rezultuar depozita në Bankën e Kursimeve dhe në BKT që nga viti 1998 deri në vitin 2019, duke krijuar bindjen se familja e bashkëshortes ka pasur mundësi për krijimin e të ardhurave dhe kursimeve nga aktiviteti i biznesit familjar.

Komisioni çmon se subjekti ka dokumentuar në masë të pranueshme mundësinë financiare të familjes së bashkëshortes, pavarësisht se këta nuk ndodhen në kushtet e pikës 4, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar burimet e ligjshme, sipas kësaj dispozite.

Përfundimisht, në vlerësim tërësor të gjithë fakteve dhe rrethanave të përmendura sa më sipër, merr rëndësi fakti se krijimi i kursimeve bankare nga bashkëshortja, i takojnë një periudhe prej disa vitesh, përpara se subjekti të ishte martuar.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se pavarësisht faktit, që nuk u provuan plotësisht të ardhurat e ligjshme të kësaj depozite bankare, nga analiza e kryer për vitet 1993 – 2003, për znj. R.N (bashkëshorte), për periudhën paramartesore me subjektin e rivlerësimit, për pasojë, balanca negative e bashkëshortes deri në vitin 2003, nuk mund të rëndojë situatën financiare të tij në vitin 2007, si dhe ta ngarkojë subjektin me përgjegjësi, me pasojë aplikimin e masës disiplinore për shkarkim nga detyra.

7. Lidhur me gjendjen e likuiditeteve *cash* të deklaruar nga subjekti, ndër vite, nga hetimi shtesë i kryer nga Komisioni, pas rishikimit të analizës së përgjithshme financiare, ka rezultuar se gjendja *cash* e deklaruar nga subjekti në fund të vitit 2016, në shumën 300.000 lekë, nuk përputhet me gjendjen e *cash-it* kumulativ të deklaruar nga subjekti, sipas DPV-ve, ndër vite, që rezulton në shumën 1.685.000 lekë.

Në lidhje me këtë, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime.

7.1 Shpjegimet e subjektit

Lidhur me gjendjen *cash* të deklaruar në vite, përmes prapësimeve të datës 26.5.2022, subjekti ka shpjeguar se në DPV-në e vitit 2016 nuk ka deklaruar gjendjen *cash* në shumën 300.000 lekë, pasi nga viti 2010 kjo gjendje e likuiditeteve *cash* nuk ka ndryshuar. Subjekti pretendon se në vitin 2010 ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* në shumën 505.000 lekë, ku gjendja *cash* në fund të vitit ka qenë në shumën 300.000 lekë, e cila ka qëndruar e pandryshuar deri në fund të vitit 2016.

7.2 Vlerësimi i Komisionit

Komisioni vëren se përlllogaritja në analizë e gjendjes *cash* kumulativ të deklaruar nga subjekti në DPV-të për vitet 2010 – 2016, nuk ka sjellë si pasojë ndonjë rezultat negativ në analizën financiare. Përfundimisht, kjo mospërputhje e deklarimeve nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, por në kuadër të deklarimeve, subjekti kishte detyrimin ligjor për të deklaruar shtesa/pakësime dhe jo gjendjen e kursimeve në fund të vitit.

Analiza financiare përmbledhëse e subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003 – 2016

PERSHKRIMI	PASURI	DETYRIME	PASURINETO	TEARDHURA	SHPENZIME	REZULTATI
2003	500 000	-	500 000	1 291 238	93 964	697 274
2004	3 875 460	4 000 000	- 124 540	1 116 759	413 964	827 335
2005	1 613 957	-	1 613 957	1 136 115	256 605	- 734 447
2006	- 81 477	- 700 000	618 523	975 331	350 371	6 437
2007	1 088 275	- 350 000	1 438 275	1 835 431	997 521	- 600 365
2008	224 307	- 400 000	624 307	1 167 510	489 123	54 080
2009	217 432	- 350 000	567 432	1 444 098	674 064	202 602
2010	528 880	- 300 000	828 880	1 578 174	902 880	- 153 586
2011	146 831	-	146 831	1 528 098	1 150 634	230 633
2012	166 087	- 120 000	286 087	1 548 806	1 190 749	71 971
2013	271 114	-	271 114	1 627 768	1 212 029	144 624
2014	298 972	-	298 972	1 845 436	1 622 995	- 76 531
2015	356 473	-	356 473	1 874 551	1 515 357	2 721
2016	117 660	-	117 660	1 803 275	1 156 020	529 595

Konkluzion përfundimtar mbi pasurinë

Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i dokumenteve të administruara në dosje, ka rezultuar se subjekti ka përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore në drejtim të saktësisë së deklaramit të pasurisë dhe justifikimit të burimeve të ligjshme dhe, për rrjedhojë, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

Për të arritur në këtë përfundim, Komisioni i është referuar edhe faktit se në analizën e financiare, për periudhën 2003 – 2016, balancat negative janë të shtrira ndër vite, duke çmuar se proporcionalisht këto konstatime nuk janë të mjaftueshme për t'u konsideruar si deklaram i pamjaftueshëm dhe që mund të çonte subjektin drejt aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjta gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, DSIK-ja ka dërguar një raport¹¹⁵, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit Hysni R Mulaj*. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

¹¹⁵Raporti për kontrollin e figurës i përcjellë nga DSIK-ja me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017.

Në vijim, Grupi i Punës, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit dhe në raportin me nr. *** prot., datë 1.12.2020¹¹⁶ nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës ka konstatuar *papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Hysni Mulaj*.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me pastërtinë e figurës, duke administruar dosjet përkatëse penale dhe verifikuar informacionet e dërguara nga autoritetet verifikuese dhe nuk u provua në lidhje me sa pretendohet në këtë informacion. Këto çështje gjenden të analizuar në kriterit e vlerësimit të aftësive profesionale.

Vlerësimi i Komisionit

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit ka rezultuar se subjekti ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës. Nga të dhënat e përditësuara nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit Hysni Mulaj ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, në përputhje me germën “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Hetimi i Komisionit, lidhur me këtë kriter, është bazuar në analizimin e:

- raportit¹¹⁷ të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit; si dhe
- kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka miratuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike, për përshkrimin dhe analizimin e dokumenteve të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit Hysni Mulaj, më detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Raporti është bazuar në të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësive profesionale;
- b) aftësive organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

1. formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit;
2. pesë dosje penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
3. të dhënat nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorive të Rretheve Gjyqësore, etj.

Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

¹¹⁶I deklasifikuar pjesërisht me vendim nr. ***, datë 9.12.2020, të KDZH-së.

¹¹⁷Raporti nr. *** prot., datë 27.4.2021, i KLP-së.

Formulari paraqitet i nënshkruar dhe i plotësuar përgjithësisht, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

ANALIZIMI I DOSJEVE TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

Nga vëzhgimi i tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të përzgjedhura me short, sikurse është shprehur edhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Komisioni ka evidentuar se:

Në dokumentin 1, në dosjen 4 dhe 5, konkluzioni i prokurorit, në aspektin arsyetues, lidhur me konstatimin e faktit penal, mbështetet në një argumentim të përgjithshëm, ku nuk analizohen elementët e figurës së veprës penale.

Në dokumentin 2 dhe 3, nuk evidentohen të dhëna nëse kërkesa për gjykimin e çështjes penale i është komunikuar secilit të pandehur, sipas parashikimit të nenit 331/3 të Kodit të Procedurës Penale.

Në dosjen 1, vendimi i mosfillimit të procedimit penal është marrë jashtë brenda afatit 30-ditor të përcaktuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, ‘Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale’, i ndryshuar”, të Prokurorit të Përgjithshëm.

Në dosjen 4, në aktin e ankimit, i cili kundërshton vendimin e gjykatës, për aplikimin e alternativave të dënimit me burgim, përfundimi i subjektit mbështetet në një analizim dhe argumentim të përgjithshëm. Në akt, nuk janë analizuar dispozitat e nenit 47 dhe 59 të Kodit Penal, në lidhje me caktimin e dënimit.

Në lidhje me konstatimet e mësipërme, subjektit iu kërkuan shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit

Me prapësimet e datë 18.3.2022, subjekti ka dhënë shpjegimet e tij për secilën nga konstatimet e Komisionit, si vijon:

Në lidhje me konstatimin e Komisionit për kryerjen e një argumentimi të përgjithshëm, ku nuk analizohen elementët e figurës së veprës penale, lidhur me procedimin penal nr. ***/2016¹¹⁸, subjekti ka shpjeguar se në vendimin e pushimit, datë 22.12.2016, është analizuar fakti i ndodhur dhe provat e siguruara, ana objektive dhe pasoja e ardhur, duke konkluduar mungesën e elementëve të figurës së veprës penale dhe në referim të kërkesave ligjore të nenit 328/1, pika “b”, është marrë vendim për pushimin e çështjes. Subjekti ka shpjeguar se në aspektin arsyetues ka bërë një analizë të faktit të ndodhur (elementët e figurës së veprës penale), ku sigurisht që ka vend për një argumentim më të thelluar, por kjo vendimmarrje nuk ka cenuar parimin e dhënies së drejtësisë.

Sa i përket konstatimit të Komisionit¹¹⁹, ku nuk evidentohen të dhëna nëse kërkesa për gjykimin e çështjes penale i është komunikuar secilit të pandehur, sipas parashikimit të nenit 331/3 të Kodit të Procedurës Penale, me prapësimet e depozituara në datën 18.3.2022, subjekti ka shpjeguar se të pandehurit dhe avokati i tyre janë njohur me akuzën dhe me gjithë provat në ngarkim të tyre (referuar procesverbalit për njohjen e të pandehurit me aktet, datë 7.10.2015 dhe datë 27.10.2015), çfarë në vetvete përbën një garanci për një proces të rregullt dhe ligjor.

¹¹⁸Dokumenti 1, çështja penale në ngarkim të shtetasit E.K, për veprën penale “shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal.

¹¹⁹Dokumenti 2, çështja penale nr. ***, viti 2015, me të pandehur (të paraburgosur) E.A dhe R.Gj, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

Lidhur me njoftimin e kërkesës për gjykimin e çështjes, subjekti ka shpjeguar se pas hartimit të kërkesës në datën 17.12.2013, në respektim të kërkesave ligjore të nenit 331/3 të Kodit të Procedurës Penale, kjo kërkesë i është njoftuar të pandehurve me shërbimin postar, duke iu dërguar kopjen e kërkesës në institucionet e paraburgimit (referuar shkresës së datës 3.11.2015, faqe 11), për institucionin e paraburgimit në Vaqar dhe shkresën e datës 3.11.2015 (faqe 12 e fashikullit), sipas kërkesave ligjore të nenit 134 /1 të Kodit të Procedurës Penale.

Në lidhje me konstatimin e Komisionit, ku në çështjen penale nr. **/2015¹²⁰ nuk evidentohen të dhëna, nëse kërkesa për gjykimin e çështjes penale i është komunikuar secilit të pandehur, sipas parashikimit të nenit 331/3 të Kodit të Procedurës Penale, në prapësimet e depozituara në datën 18.3.2022, subjekti ka shpjeguar se të pandehurit dhe avokati i tyre janë njohur me akuzën dhe me të gjithë provat në ngarkim të tij (referuar procesverbalit për njohjen e të pandehurit me aktet më 14.10.2015), çfarë në vetvete përbën një garanci për një proces të rregullt dhe ligjor.

Në lidhje me njoftimin e kërkesës për gjykim, subjekti ka shpjeguar se pas hartimit të kërkesës në datën 15.10.2015, në respektim të kërkesave ligjore të nenit 331/3 të Kodit të Procedurës Penale, kjo kërkesë i është njoftuar të pandehurit dhe viktimës me shërbimin postar në adresat e deklaruara prej tyre (referuar shkresës së datës 15.10.2015, faqe 3 dhe 4 të fashikullit), sipas kërkesave ligjore të nenit 134 /1 të Kodit të Procedurës Penale.

Në lidhje me dosjen 1, që i përket kallëzimit penal nr. ***, datë 7.11.2014, për veprën penale “pushtimi i tokës”, parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal dhe konstatimin e Komisionit se vendimi i mosfillimit, datë 10.1.2015, është marrë në kalim të afatit 30-ditor (përcaktuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, i ndryshuar, i Prokurorit të Përgjithshëm), subjekti ka shpjeguar se ky material është marrë në dorëzim nga sekretaria në datën 26.11.2014 dhe nga studimi i tij ka rezultuar se kishte nevojë për kryerjen e disa veprime verifikuese, për të cilat është ngarkuar oficeri i policisë gjyqësore, i cili në datën 10.1.2015 ka sugjeruar mosfillimin e procedimit penal. Nga analiza e fakteve, provave dhe verifikimeve të kryera, fakti i mësipërm nuk përmbante elementet e figurës së veprës penale të parashikuar në nenin 200 të Kodit Penal dhe palët janë orientuar që fillimisht t’i drejtohen organeve të pushtetit lokal dhe sipas rastit gjykatës së juridiksionit civil, me padi të veçantë për pushimin e cenimit të pronësisë. Në këto kushte, në referim nenit 290/1, germa “ç”, të Kodit të Procedurës Penale, u mor vendim për mosfillimin e procedimit penal në datën 10.1.2015.

Sipas shpjegimeve të subjektit, moskryerja e veprimeve të nevojshme mund të cenonte zgjidhjen ligjore të rastit dhe ky tejkallim në rastin konkret është kryer për marrjen e dokumenteve (subjekti referon procesverbalin e datës 8.1.2015), duke shpjeguar se në këtë tejkallim afati, ka ndikuar edhe ngarkesa e madhe në punë, si për subjektin edhe për oficerin e policisë gjyqësore të ngarkuar me kryerjen e veprimeve verifikuese dhe faktin e festave të fundvitit. Sipas shpjegimeve të subjektit, kjo vendimmarrje nuk ka cenuar parimin themelore kushtetues të marrjes së vendimit në një kohë të arsyeshme, në funksion të dhënies së drejtësisë për qytetarin.

Në lidhje me konstatimin e Komisionit, për një argumentim të përgjithshëm, subjekti ka shpjeguar se argumentimi në tërësinë e tij pasqyron detajet e faktit të kallëzuar, provat, si dhe veprimet verifikuese të kryera prej tij dhe policisë gjyqësore në funksion të vendimmarrjes.

Në lidhje me konstatimin e Komisionit, se në diskutimet përfundimtare evidentohet se nuk janë respektuar parashikimet e nenit 47 të Kodit Penal, subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me

¹²⁰Dokumenti 3, çështja penale në ngarkim të të pandehurit A.A, i akuzuar për veprat penale “shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” dhe “drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar përkatësisht nga nenet 290/2 dhe 291, të Kodit Penal.

çështjen penale nr. ***/2013¹²¹, ku në analizë të kësaj gjetje, ka shpjeguar se në konkluzionet përfundimtare të datës 12.2.2014, pavarësisht se nuk janë cituar shprehimisht rrethanat që lidhen me rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe autorit, nga ana e tij, në caktimin e llojit e masës së dënimit, janë marrë në konsideratë të gjitha elementet që përcaktojnë rrezikshmërinë e autorit dhe veprës penale. Aplikimi i llojit dhe masës së dënimit të kërkuar nga subjekti është marrë në konsideratë edhe nga gjykata në vendimarrjen e saj. Subjekti ka shpjeguar se kjo gjetje e Komisionit është me vend, por ka ardhur dhe si pasojë e ngarkesës në punë.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, vlerëson se ndonëse janë konstatuar mangësi në veprimet e tij, sa i përket arsytimit të përgjithshëm lidhur me këto çështje penale dhe analizimin e elementëve të veprës penale, kjo rrethanë çmohet e pamjaftueshme për ta konsideruar subjektin me aftësi profesionale poshtë nivelit minimal të kërkuar nga germa “c”, pika 1, e nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, për kualifikimin e subjektit.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE

1. Nga verifikimi i të dhënave nga Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, si dhe të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë:

i) Nuk rezulton të ketë masa disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit, për periudhën 2006 – 2019, si dhe nuk ka të dhëna të dokumentuara të përfshirjes së tij në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale).

ii) Nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e korrespondencës së informacionit të klasifikuar të Prokurorisë së Përgjithshme nga viti 2012 (vit në të cilin është krijuar sekretaria sekrete) dhe në vazhdim rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit Hysni Mulaj nuk ka ndonjë të dhënë apo *indicie* të ardhur nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve ndaj tij.

iii) Nga verifikimet e kryera në zyrën e regjistratit në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit Hysni Mulaj është regjistruar vetëm një material hetimor, ku çështja nuk ka pasur autor të regjistruar dhe në përfundim të hetimeve, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka vendosur pushimin e procedimit.

2. Nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave, rezulton se për subjektin e rivlerësimit Hysni Mulaj ka dy ankesa dhe nga verifikimi nuk ka rezultuar marrja e ndonjë mase disiplinore ndaj subjektit.

3. Pranë Drejtorisë Ekonomike dhe të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë ka të dhëna për vlerësimin e punës së këtij prokurori, të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 42, të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i shfuqizuar, si dhe urdhrin nr. 221, datë 19.11.2012, “Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”.

Konkretisht, janë administruar tri vendimet e Prokurorit të Përgjithshëm “Për vlerësimin e punës së prokurorit”, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, ku prokurori Hysni Mulaj është vlerësuar “*shumë mirë*”.

ANALIZA E GJETJEVE

¹²¹Dosja 5, çështja penale në ngarkim të të pandehurit M.K, për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278 /3 i Kodit Penal.

Sipas kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga analizimi i tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short ka rezultuar se:

1. Aftësitë profesionale

Subjekti i rivlerësimit, nga dosjet e vëzhguara, ka identifikuar normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet dhe përgjithësisht analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit.

Subjekti i rivlerësimit Hysni Mulaj shfaq aftësi në arsyetim ligjor, ku aktet e arsyetuara prej tij janë të kuptueshme, duke u dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për zgjidhje. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, përgjithësisht analizon elementët e figurës së veprës penale objekt hetimi. Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

2. Aftësitë organizative

Subjekti i rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit, ka trajtuar gjithsej 970 çështje penale së bashku me ato të pezulluara. Sipas të dhënave statistikore, konstatohet se prokurori ka përballuar ngarkesë pune të lartë gjatë periudhës së rivlerësimit me efikasitet. Nga analizimi i pesë dosjeve të përzgjedhura në short, qëndrimi i subjektit ka qenë brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Hysni Mulaj, është eficient dhe efektiv.

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të përzgjedhura, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, të vendosura në rend kronologjik, na njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe disponimin e gjykatës.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Nga aktet vëzhguara, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Për periudhën e rivlerësimit, tetor 2013 – tetor 2016, nuk rezultoi të jetë marrë asnjë masë disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit.

Nga vëzhgimi dosjeve të përzgjedhura, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, si dhe nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Prokurori Hysni Mulaj nuk ka deklaruar në formularin e vetëvlerësimit trajnime të kryera pranë Shkollës së Magjistraturës brenda periudhës së rivlerësimit. Nga subjekti janë dorëzuar dokumente të tjera, ku ka qenë pjesëmarrës në trajnime të tjera të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës jashtë periudhës së rivlerësimit, si dhe trajnime të kryera jashtë programit të saj.

5. Lidhur me informacionet e ardhura nga institucionet e verifikimit

Komisioni analizoi tri çështje penale, ku në dy prej tyre nuk u provua në lidhje me sa pretendohet në këtë informacion, ndërsa i kërkoi subjektit shpjegime, lidhur me çështjen penale në ngarkim të të pandehurve Rr. M dhe N.D, për veprën penale “falsifikim të akteve të gjendjes

civile”, të parashikuar nga neni 191/1¹²² dhe 191/3¹²³ i Kodit Penal, i hetuar nga prokurori Hysni Mulaj, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Bulqizë.

Komisioni ka evidentuar se nuk janë analizuar shkaqet ligjore në bazë të të cilave është vendosur pushimi e procedimit penal, pasi nga aktet në dosje, duket se shtetasi N.D ka konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 191/1 i Kodit Penal.

Në lidhje me këtë konstatim, Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit

Lidhur me këtë dosje penale, në prapësimet e depozituara në datën 18.3.2022, subjekti ka shpjeguar se vendimmarrja e datës 3.7.2006, për pushimin e çështjes, është rezultat i një analize në tërësi dhe në unitet me njeri-tjetrin i të gjitha fakteve dhe provave të grumbulluara gjatë hetimit, që kanë të bëjnë me elementet e anës objektive (veprimet e mosveprimet e personit nën hetim R.M, si përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile, me kërkesë të shtetasit M. D) dhe elementet e anës subjektive të personave nën hetim (qëndrimin e tij ndaj veprimit e mosveprimit).

Subjekti ka shpjeguar se në analize të këtyre provave dhe fakteve të marra në unitet me njëra-tjetrën u konkluduar se lëshimi i kësaj certifikate personale me të gjitha të dhënat e sakta me përjashtim të vitlindjes, krijoi bindjen e bazuar ne prova se shtetasi Rr.M këtë gabim material e ka kryer pa faj (në pakujdesi) dhe ky fakt nuk parashikohej nga ligji si vepër penale. Gjithashtu, nga analiza e provave dhe fakteve, nuk u provua, te j çdo dyshimi (neni 4/1 i Kodit të Procedurës Penale), se shtetasi M (N) D ka pasur dijeni dhe me dashje ka përdorur një dokument të falsifikuar, për t’u pajisur me pasaportë.

Nisur nga këto rrethana dhe prova, subjekti ka konkluduar se mungojnë elementët e figurës së veprës penale nga ana subjektive (faji), fakt i cili nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe në referim të kërkesave të germës “b”, të nenit 328/1, të Kodit të Procedurës Penale, është marrë dhe vendimi i pushimit të çështjes për këta shtetas.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, në analizë të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, i vlerësoi bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti në prapësimet e tij. Komisioni vëren se, megjithëse subjekti nuk ka analizuar elementët e veprës penale dhe shkaqet ligjore të pushimit të çështjes, nuk konstatoi problematika thelbësore, në kuptim të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, në atë shkallë sa ta konsiderojë subjektin me mangësi të aftësive profesionale.

DENONCIMET NGA PUBLIKU

Për subjektin e rivlerësimit Hysni Mulaj janë depozituar në total tri denoncime nga publiku, një prej të cilëve është depozituar në datën 23.3.2022, para zhvillimit të seancës dëgjimore.

Nga analizimi i denoncimeve, në dy prej tyre nuk u evidentuan problematika, pasi nuk ishin objekt shqyrtimi nga Komisioni dhe nuk përmbanin fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

1. Lidhur me denoncimin e shtetasës me iniciale E. M. (G), e cila pretendon se prokurori Hysni Mulaj nuk e ka njoftuar mbi vendimin e pushimit të hetimeve dhe, për pasojë, nuk i është dhënë

¹²² “Falsifikimi apo përdorimi i akteve të gjendjes civile të falsifikuara dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet”.

¹²³ “Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë aktin, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet”.

mundësi për të ushtruar të drejtën e ankimit, e drejtë e parashikuar në Kodin e Procedurës Penale.

Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë dokumentacion, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit

Në prapësimet e depozituara në Komision në datën 18.3.2022, subjekti ka shpjeguar se kallëzimi penal nr. ***, është regjistruar në datën 30.9.2020 dhe i është dorëzuar fizikisht nga zyra e regjistrimit të procedimeve më 16.10.2020.

Sa i takon pretendimit të denoncueses se nuk është njoftuar për mbylljen e hetimeve, subjekti ka shpjeguar se në referim të detyrimeve ligjore të nenit 291/2 të Kodit të Procedurës Penale, kopja e vendimit për mosfillimin e procedimit penal i është dërguar përmes shërbimit postar kallëzueses G. M., e cila është administratore e shoqërisë me ortake të vetme denoncuesen, në adresën e deklaruar prej saj. Subjekti ka depozituar kopjen e fashikullit të kallëzimit penal nr. ***, datë 30.9.2020 dhe një kopje të fletës së regjistrimit të procedimeve penale, ku dokumentohet marrja në dorëzim e këtij kallëzimi nga subjekti, si dhe kopja e zarfit të shërbimit postar, mbi dërgimin e njoftimit.

Vlerësimi i Komisionit

Nga analizimi i dosjes penale, lidhur me njoftimin e palëve për vendimin e mosfillimit, rezulton e provuar se subjekti ka respektuar detyrimin procedural të njoftimit të vendimit, kallëzueses dhe të kallëzuarit, në përputhje me përcaktimet e nenit 291/2 të Kodit të Procedurës Penale.

Sa më sipër, nga analizimi i dosjes penale, nuk u provuan pretendimet e denoncueses.

2. Gjatë hetimit shtesë, Komisioni ka administruar dosjen penale nr. ***/2008, me kallëzues shtetasin me initiale B. B., lidhur me vjedhjen e një automjeti në datën 7.1.2008, me targa të huaja, në pronësi të kallëzuesit, i cili ka qenë i parkuar para pallatit të tij.

Nga analizimi i dosjes nga Komisioni ka rezultuar se për këtë çështje nuk janë ndërmarrë veprime hetimore nga oficeri i policisë gjyqësore, si dhe as nga subjekti i rivlerësimit.

Në lidhje me këtë konstatim, subjektit i janë kërkuar shpjegime, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit

Subjekti, përmes prapësimeve të datës 26.5.2022, ka shpjeguar se nga aktet e këtij materiali kallëzues ka rezultuar se ky referim nga ana e policisë gjyqësore ishte i mangët dhe i pabazuar në asnjë provë në kuptim të ligjit procedural penal (si mund të jetë këqyrje e vendit të ngjarjes, marrje e dëshmive të personave që kanë dijeni për hetimin, sekuestrimet etj.), duke kufizuar ndjeshëm mundësinë e një hetimi të plotë dhe dinamik në lidhje me këtë fakt, i cili mbështetej vetëm në një burim prove që ishte njoftimi nga i dëmtuari B. B., i cili në dëshminë e tij nuk ishte në gjendje të kujtonte targën e mjetit.

Në funksion të një hetimi sa më të plotë dhe objektiv të këtij fakti në datën 11.1.2008, subjekti ka ngarkuar policinë gjyqësore të bashkërendojë punën me shërbimet e policisë gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë (seksionit kundër vjedhjeve të automjeteve), me qëllim mbledhjen e ndonjë informacioni në rrugë operative apo të ndonjë prove të mundshme për autorin e kryerjes së kësaj veprë penale.

Pasi u analizuan faktet dhe burimet e provave, duke qenë se nuk u bë e mundur të identifikohet autori i veprës penale, në referim të kërkesave ligjore të nenit 326/1/2 të Kodit të Procedurës

Penale në datën 31.1.2008, subjekti ka vendosur pezullimin e hetimeve, duke e dërguar fashikullin e hetimit paraprak për ndjekje të mëtejshme Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë.

Duke qenë se nga ana e policisë gjyqësore nuk u sigurua asnjë informacion apo prove që mund të çojë në zbulimin e autorit të kësaj vepre penale, një prokurore tjetër, me vendimin e datës 21.1.2014, ka vendosur pushimin e çështjes, pasi ndodhej ne kushte ligjore të nenit 66 të Kodit Penal (parashkrimi i ndjekjes penale).

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, pasi vlerësoi shpjegimet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në raport edhe me faktet e konstatuara, evidenton se çështja penale në fjalë nuk ka marrë zgjidhje, jo për shkak të një hetimi të mangët të kryer nga subjekti, e cila mund të përbënte shkak për cenimin e aftësive profesionale të subjektit dhe cenim të besimit të publikut, por për shkak të rrethanave të tilla të cilat pengonin kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore. Komisioni ka vlerësuar se në tërësi nuk ka pasur fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në cenimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Në përfundim të rivlerësimit profesional, nga hetimi i thellë administrativ i kryer, nuk u provua asnjë *indicie* apo element që cenon figurën e prokurorit Hysni Mulaj, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se, pavarësisht problematikave të konstatuara, në vlerësim tërësor të këtij kriteri ka arritur një nivel kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me germën “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Hysni Mulaj ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Hysni Mulaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, më 8.6.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Suela ZHEGU
Relatore

Firdes SHULI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha